



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 71

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 17 maj 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 240, datë 2.5.2018	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, në emër të Bashkimit Evropian, për IPARD II 2014–2020, asistencë për zhvillimin bujqësor dhe rural, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit, IPA II.....
	4499
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 245, datë 9.5.2018	Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2018, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave.....
	4505
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.247, datë 9.5.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues, në Republikën e Malit, në Afrikë”, të ndryshuar.....
	4506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 9.5.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 440, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”.....
	4506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 249, datë 9.5.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 763, datë 2.11.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e ngjyrës, shenjave dhe përdorimin e mjeteve të Policisë së Shtetit”.....
	4508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 9.5.2018	Për një rishpërndarje të fondeve të infrastrukturës vendore dhe rajonale nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në disa njësi të qeverisjes qendrore.....
	4508

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 9.5.2018	Për miratimin e letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruara nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe të mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik.....	4510
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.5.2018	Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).....	4514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 9.5.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 182, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (<i>Lead Manager</i>) dhe/ose huadhënësit për realizimin e huamarrjes me instrumente financiare në tregun e huaj”.....	4515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 9.5.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 58, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i Projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier–Vlorë” me programe sociale të strehimit”, të ndryshuar.....	4515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 9.5.2018	Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit.....	4516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 9.5.2018	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.....	4516
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 7, datë 11.5.2018	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2018, grantet “Arsimi”.....	4521
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 8, datë 11.5.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I”.....	4527
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 9, datë 11.5.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 12.4.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, të grantit “Shqipëria Dixhitale”, programi “Shqipëria Dixhitale”, shtylla II”.....	4528
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 14.5.2018	Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit.....	4529
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 61, datë 26.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.....	4537
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 26.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.....	4538

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 26.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 3” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaike në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.....	4539
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 26.3.2018	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “RTS” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimi gjenerues i energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë.....	4540
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 26.3.2018	Mbi miratimin e rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial.....	4541
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 26.3.2018	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajt janar dhe shkurt 2018.....	4545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 26.3.2018	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2018.....	4547
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 26.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e një ndryshimi në rregullat “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”	4547
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 26.3.2018	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për lënien peng në favor të Raiffeisen Bank sh.a. të aseteve të saj, për efekt të ristrukturimit të kredisë.....	4549
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 26.3.2018	Mbi heqjen e licencës nr. 123, seria PV11k, shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k. për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Trebinjë”, “Potgozhan”, “Kalivaç”, “Dunicë 1”, “Dunicë 2”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011.....	4550
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 26.3.2018	Mbi heqjen e licencës nr. 124, seria T11P, shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., për tregtimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011.....	4551
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 26.3.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4552
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 26.3.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, “Seta 3” dhe “Seta 4”	4553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 26.3.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a. në “Kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s.....	4554
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 26.3.2018	Mbi detyrimin e shoqërisë OSHEE sh.a. për nënshkrimin e “Kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s.....	4557

**VENDIM****Nr. 240, datë 2.5.2018****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT
EVROPIAN, NË EMËR TË BASHKIMIT
EVROPIAN, PËR IPARD II 2014-2020,
ASISTENCA PËR ZHVILLIMIN
BUJQËSOR DHE RURAL, SIPAS
INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E
PARAADERIMIT, IPA II**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, në emër të Bashkimit Evropian, për IPARD II 2014-2020, asistencë për zhvillimin bujqësor dhe rural, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit, IPA II, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****IPARD II ASISTENCA
PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RURAL
SIPAS INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E
PARAADERIMIT IPA II****MARRËVESHJE FINANCIMI 2014–2020
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT EVROPIAN NË EMËR TË
BASHKIMIT EVROPIAN****MARRËVESHJE FINANCIMI 2014–2020**

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni”, duke vepruar për dhe në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si “Bashkimi”, nga njëra anë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, duke vepruar për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, në vijim e referuar si “Shqipëria”, nga ana tjetër dhe

bashkërisht të referuara si “Palët Kontraktuese”,

Duke pasur parasysh se:

1. Është vendosur një Instrument i ri i Asistencës së Paraaderimit me Rregulloren (BE) nr. 231/2014¹ (në vijim e referuar si “Rregullorja IPA II”) që parashikon asistencën financiare të Bashkimit Evropian, ndërmjet të tjerash, në fushën e politikës për bujqësinë dhe zhvillimin rural në përfituesit e renditur në shtojcën I të kësaj Rregulloreje.

2. Në pajtim me shtojcën I të Rregullores IPA II, Shqipëria është e pranueshme për të qenë përfituese sipas programeve të zhvillimit rural IPA II.

3. Neni 7 i Rregullores IPA II parashikon që asistencë e Bashkimit do të zbatohet me ndërmjetësimin e programeve të ngritura nga përfituesit e IPA II, në pajtim me prioritetet e përcaktuara në Dokumentin e Strategjisë Orientuese. Dokumenti i Strategjisë Orientuese është hartuar për kohëzgjatjen e kuadrit financiar shumëvjeçar të BE-së nga Komisioni në partneritet me Shqipërinë, në pajtim me nenin 6 të Rregullores së IPA II. Komisioni ka miratuar Dokumentin e Strategjisë për Shqipërinë, me vendimin C(2014) 5770, të datës 18 gusht 2014.

4. Neni 2(1) i Rregullores (BE) nr. 236/2014² (në vijim e referuar si “Rregullore zbatuese e përbashkët”) parashikon që Komisioni mund të miratojë programe veprimi shumëvjeçare, në pajtim me nenin 6(3) të kësaj Rregulloreje.

5. Neni 55 i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 447/2014³ (në vijim e referuar si “Rregullore zbatuese IPA II”) përmban dispozitat për përpilimin e programeve shumëvjeçare të zhvillimit rural sipas Instrumentit të Asistencës së Paraaderimit IPA II.

6. Në pajtim me paragrafin e dytë të kësaj dispozite, programet e zhvillimit rural zbatohen

¹ Rregullore (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që vendos një Instrument të Asistencës së Paraaderimit (IPA II) (GZ L 77, 15.3.2014, f. 11).

² Rregullore (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që vendos rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Bashkimit për financimin e masave me efekt të jashtëm (GZ L 77, 15.3.2014, f. 95).

³ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 447/2014, e datës 2 maj 2014, mbi rregullat e posaçme për zbatimin e rregullores (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që vendos një Instrument për Asistencën e Paraaderimit (GZ L 132, 3.5.2014, f. 32).



mbi bazën e menaxhimit jo të drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 59(1) të Rregullores (BE EURATOM) nr. 966/2012⁴ (në vijim e referuar si “Rregullore Financiare”).

7. Shqipëria ka miratuar një program shumëvjeçar për zhvillimin rural për periudhën 2014–2020 sipas IPA II (në vijim i referuar si Programi IPARD II) dhe ia ka paraqitur atë Komisionit për miratim në datën 2 mars 2015. Programi IPARD II u miratua me vendimin e Komisionit C(2015) 5073 të datës 20 korrik 2015.

8. Sipas nenit 6(1) të Rregullores Zbatuese IPA II, Vendimi i Komisionit që miraton programin përbën edhe një vendim financiar në lidhje me nenin 84(3) të Rregullores Financiare dhe nenin 94 të Rregullores së Deleguar (BE) nr. 1268/2012⁵.

9. Për zbatimin e asistencës IPA II, neni 5 i Rregullores Zbatuese IPA II parashikon lidhjen e marrëveshjeve kuadër dhe sektoriale ndërmjet Komisionit dhe përfituesve IPA II.

10. Marrëveshja Kuadër e miratuar nga vendimi i Komisionit C(2014) 6014, e datës 27 gusht 2014 dhe e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë më 16 prill 2015, përcakton parimet menaxhimit dhe të zbatimit të asistencës IPA IPA II ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë.

11. Marrëveshja Sektoriale e miratuar me vendimin e Komisionit C(2015) 1662, e datës 18 mars 2015 dhe e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë më 26 prill 2016, plotëson Marrëveshjen Kuadër dhe mbulon dispozitat specifike të zbatueshme për zbatimin e Programit IPARD II.

12. Më 21 qershor 2017, Shqipëria njoftoi Komisionin në lidhje me listën e shpenzimeve të pranueshme për masat e mëposhtme të programit IPARD II:

- Investim në asetet fizike të njësive bujqësore;
- Investime në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;

- Diversifikimi fermer dhe zhvillimi i biznesit;
- Asistencë teknike.

Më 19 korrik 2017, me letrën Ares (2017) 3641066, Komisioni, pas rishikimit të letrës, njoftoi Shqipërinë për pranimin e saj.

13. Marrëveshja Financiare ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë parashikon përfundimin e angazhimeve ligjore shumëvjeçare për vitet 2014–2010, sipas parashikimit në shtojcën e kësaj marrëveshjeje dhe në nenin 2 të vendimit të Komisionit C(2015) 5073, të datës 20 korrik 2015, miratoi programin IPARD II.

14. Në pajtim me nenin 58(1), pika (c) të Rregullores Financiare dhe nenin 7 të Rregullores IPA II, Komisioni do ta zbatojë buxhetin me ndërmjetësim, duke ua besuar zbatimin e detyrave të buxhetit përfituesve të IPA II.

15. Në pajtim me nenin 13(1) të Rregullores Zbatuese IPA II, caktimi i detyrave për zbatimin e buxhetit Shqipërisë do të kryhet duke lidhur një marrëveshje financiare në pajtim me nenet 60(1) dhe (2), 61 dhe 184(2)(b) të Rregullores Financiare.

16. Neni 14(3) i Rregullores Zbatuese IPA II parashikon që para se Komisioni të caktojë detyrat e zbatimit të buxhetit të asistencës IPA II, ai rishikon kërkesën e Zyrtarit Autorizues Kombëtar për caktimin e detyrave të zbatimit të buxhetit Shqipërisë dhe strukturave dhe autoriteteve dhe, për qëllimet e vlerësimit *ex-ante* në pajtim me nenin 61(1) të Rregullores Financiare, merr prova që janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat (a) deri (d) të nënparagrafit të parë të nenit 60(2) të Rregullores financiare dhe atyre të nenit 13(3) të Rregullores Zbatuese IPA II.

17. Neni 12 i Marrëveshjes Kuadër përcakton kushtet për caktimin e detyrave të zbatimit të buxhetit përfituesit të IPA II. Në veçanti, përfituesi i IPA II, gjatë menaxhimit të fondeve IPARD II, respekton parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, transparencës dhe mosdiskriminimit dhe garanton vizibilitetin e asistencës IPA II. Përfituesi IPA II garanton një nivel mbrojtjeje të interesave financiare të Bashkimit Evropian të barasvlershëm me atë që kërkohet sipas Rregullores Financiare.

18. Në pajtim me nenin 13 të Marrëveshjes Kuadër, NAO, në emër të Shqipërisë, është përgjegjëse për paraqitjen në Komision të një kërkesë për t’iu besuar detyrat e zbatimit të buxhetit sipas Programit IPARD II. Para paraqitjes së kërkesës, NAO garanton që struktura e

⁴ Rregullore (BE Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, që vendos rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE Euratom) nr. 1605/2002 (GZ L 298, 26.10.2012, f. 1).

⁵ Komisioni, Rregullore e Deleguar (BE) 1268/2012, e datës 29 tetor 2012, mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (BE Euratom) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit (GZ L 362, 31.12.2012, f. 1).



menaxhimit dhe struktura operative përkatëse përmbush kushtet e pikave (a) deri (d) të nenit 12(3) dhe ato të shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër.

19. Kushtet e hollësishme për caktimin e detyrave janë përcaktuar më tej në nenet 23 dhe 24 të Marrëveshjes Sektoriale.

20. Strukturave dhe autoriteteve të parashikuara në nenin 10 të Marrëveshjes Kuadër u caktohen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me shtojcën A të Marrëveshjes Kuadër dhe shtojcën 1 të Marrëveshjes Sektoriale.

21. Shqipëria ka ngritur strukturat dhe autoritetet përgjegjëse për menaxhimin me ndërmjetësim të asistencës IPARD II: Koordinatorin Kombëtar IPA (NIPAC), Zyrtarin Autorizues Kombëtar (NAO), Zyrën Mbështetëse NAO (NAO SO), Fondin Kombëtar (NF), Autoritetin Menaxhues (MA), Agjencinë IPARD (IA) dhe Autoritetin e Auditimit (AA). Shqipëria ka caktuar Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për të përmbushur funksionet e caktuara NIPAC-ut. Konfirmimi i vetë NIPAC-ut për gatishmërinë e tij përfshihet në kërkesën për caktimin e zbatimit të buxhetit.

22. Shqipëria ka caktuar Ministrinë e Financave për të përmbushur funksionet dhe përgjegjësitë e caktuara NAO-s, sipas parashikimit në nenin 7 të Marrëveshjes Sektoriale. Konfirmimi i vetë NAO-s për gatishmërinë e tij përfshihet në kërkesën për caktimin e zbatimit të buxhetit.

23. Zyrtari Autorizues Kombëtar ka ngritur një strukturë të përbërë nga një fond Kombëtar dhe një Zyrë Mbështetëse për NAO-n brenda Ministrisë së Financave.

24. Për strukturën operative të referuar në pikën (c) të nenit 10(1) të Marrëveshjes Kuadër, Shqipëria ka caktuar:

i) Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të IPARD-it pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të vepruar si Autoritet Menaxhues që përmbush funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 8 të Marrëveshjes Sektoriale; dhe

ii) Ka ngritur Agjencinë IPARD që përmbush funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 9 të Marrëveshjes Sektoriale.

25. Shqipëria ka ngritur Autoritetin e Auditimit. Konfirmimi i vetë Autoritetit të Auditimit për gatishmërinë e tij përfshihet në kërkesën për caktimin e zbatimit të buxhetit.

26. Në pajtim me nenin 25 të Marrëveshjes Sektoriale, NAO i paraqiti më 20 shtator 2016 Komisionit, kërkesën zyrtare për t'iu ngarkuar detyrat e zbatimit të buxhetit sipas masave të mëposhtme të Programit IPARD II:

- Investim në asetet fizike të njëjësive bujqësore;
- Investime në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;
- Diversifikimi fermer dhe zhvillimi biznesit.

Kërkesa përfshinte të gjithë dokumentacionin e kërkuar në pajtim me shtojcën 3 të Marrëveshjes Sektoriale dhe në pajtim me paragrafin e dytë të nenit 13(2) të Marrëveshjes Kuadër.

27. Në pajtim me nenin 13(4) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni ka rishikuar kërkesën për caktimin e detyrave për zbatimin e buxhetit dhe strukturat dhe autoritetet e ngritura. Për qëllimet e *vlërësimit ex-ante* në pajtim me nenin 61(1) të Rregullores Financiare, Komisioni ka marrë prova që janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat (a) deri (d) të nenit 12(3) dhe atyre të shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër.

28. Si rrjedhojë, është e përshtatshme që të përmbushet kërkesa për caktimin e detyrave të zbatimit të buxhetit, duke hequr dorë nga e drejta e Komisionit të përmendur në nenin 50(1), nënparagrafi dytë, pika (a) e Marrëveshjes Kuadër.

29. Si rrjedhojë, është e nevojshme të përcaktohen në Marrëveshjen Financiare: i) angazhimet financiare të Bashkimit për zbatimin e Programit IPARD II për Shqipërinë për periudhën 2014–2020 dhe për të caktuar afatin e vlefshmërisë së këtyre angazhimeve në pajtim me nenin 189 të Rregullores Financiare; dhe ii) dispozitat për caktimin Shqipërisë të detyrave për zbatimin e buxhetit.

30. Të gjitha shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punës jepen dhe zbatohen në pajtim me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e masave me efekt të jashtëm, në fuqi në kohën e fillimit të procedurave në fjalë. Duke u shmangur nga neni 18(2) i Marrëveshjes Kuadër, marrëveshjet e grantit jepen dhe zbatohen në pajtim me procedurat IPARD, në fuqi në kohën e shpalljes së kërkesës për aplikim, të paraqitura dhe të pranuar nga Komisioni, në pajtim me nenet (5) dhe 12(1) të Marrëveshjes Kuadër dhe nenit 25 të Marrëveshjes Sektoriale.



Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti

1. Kjo Marrëveshje Financiare, në shtojcën bashkëlidhur, përcakton angazhimet financiare të Bashkimit për Programin IPARD II për Shqipërinë për vitet 2014–2020 dhe vlefshmërinë e këtyre angazhimeve.

2. Kjo Marrëveshje Financiare përmban dispozita për caktimin Shqipërisë të detyrave të zbatimit të buxhetit.

Neni 2

Marrëveshjet dhe interpretimi

Marrëveshja Financiare plotëson dispozitat e Marrëveshjes Sektoriale dhe të Marrëveshjes Kuadër. Në rast konflikti ndërmjet Marrëveshjes Financiare dhe dispozitave të Marrëveshjes Sektoriale dhe Marrëveshjes Kuadër, këto të fundit kanë përparësi.

Përveç kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje Financiare, termat e përdorur në këtë Marrëveshje Financiare kanë të njëjtin kuptim që u jepet atyre në Marrëveshjen Sektoriale, Marrëveshjen Kuadër, Rregulloren IPA II, Rregulloren e Përbashkët për Zbatimin, Rregulloren e Zbatimit IPA II dhe Rregulloren Financiare, të ndryshuar, të plotësuar ose të zëvendësuar, sipas rastit.

Neni 3

Asistenca financiare

1. Në pajtim me nenin 58(1)(c) të Rregullores Financiare, Programi IPARD II për Shqipërinë do të zbatohet nën menaxhimin me ndërmjetësim sipas parashikimit në vendimin e Komisionit C(2015) 5073, të datës 20 korrik 2015.

2. Asistenca IPARD do të zbatohet me menaxhim me ndërmjetësim pa verifikim *ex-ante* të tenderimit dhe kontraktimit nga Komisionit ose Delegacioni i Bashkimit.

3. Në pajtim me nenin 31 të Marrëveshjes Sektoriale, Programi IPARD II bashkëfinancohet nga Bashkimi dhe Shqipëria. Detajimi i kontributeve përkatëse financiare parashikohet në Programin IPARD II të miratuar me vendimin e Komisionit C(2015)5073, të datës 20 korrik 2015.

4. Kontributi i Bashkimit bashkëfinancon shpenzimet publike që u paguhen faktikisht

përfituesve. Kontributet e ndihmës dhe norma e kontributit të Bashkimit janë në pajtim me normat dhe limitet e parashikuara në shtojcën 4 të Marrëveshjes Sektoriale.

5. Kontratat, në ndryshim nga shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punës jepen dhe zbatohen në pajtim me procedurat IPARD, në fuqi në kohën e shpalljes së kërkesës për aplikim, të paraqitur dhe të pranuar nga Komisioni në pajtim me nenet (5) dhe 12(1) të Marrëveshjes Kuadër dhe nenit 25 të Marrëveshjes Sektoriale.

6. Financimi i Bashkimit i nënshtrohet përmbushjes së detyrimeve nga Shqipëria të parashikuara në Marrëveshjet Kuadër dhe Sektoriale dhe në Marrëveshjen Financiare.

PJESA I

ANGAZHIMET FINANCIARE 2014–2020

Neni 4

Angazhimet

1. Kontributi financiar i Bashkimit për secilin prej viteve nga 2014–2020 është i kufizuar në shumat për vit të parashikuara në vendimin e Komisionit, të datës 20 korrik 2015 dhe në shtojcën bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje. Këto angazhime janë të vlefshme vetëm për zbatimin e Programit IPARD II, në pajtim me Marrëveshjen Kuadër dhe Marrëveshjen Sektoriale të lidhur përkatësisht ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë më 16 prill 2015 dhe 26 prill 2016.

2. Angazhimet buxhetore të Bashkimit jepen në këste vjetore. Angazhimi buxhetor për këstin e parë pason miratimin e Programit IPARD II nga Komisioni.

3. Në pajtim me paragrafin e fundit të nenit 6(3) të Rregullores së Përbashkët të Zbatimit, angazhimet buxhetore i nënshtrohen disponibilitetit të pjesëve që pasojnë miratimin e buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit për vitin përkatës ose sipas parashikimit në sistemin e dymbëdhjetësheve provizore.

4. Komisioni informon me shkrim Shqipërinë në lidhje me miratimin e çdo angazhimi buxhetor vjetor që tregohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Afati i anulimit të angazhimit

Në pajtim me nenin 34 të Marrëveshjes Sektoriale, Komisioni anulon automatikisht çdo



pjesë të angazhimeve buxhetore të treguara në shtojcën për Programin IPARD II që nuk është përdorur deri më 31 dhjetor të vitit të tretë pas atij të angazhimit buxhetor (rregulli “n+3”).

- Për qëllimin e parafinancimit në pajtim me nenin 38 të Marrëveshjes Sektoriale; ose

- Duke kryer pagesa të ndërmjetme në pajtim me nenin 37 të Marrëveshjes Sektoriale; ose

- Për të cilin NAO e besuar me detyrat e zbatimit të buxhetit, nuk ka paraqitur një pagesë për kërkesë, duke përfshirë një pasqyrë të vërtetuar të shpenzimeve në pajtim me nenin 35(1) të Marrëveshjes Kuadër dhe nenin 37(1) të Marrëveshjes Sektoriale.

Megjithatë, në rrethanat e justifikuara sipas rregullave, të pranura nga Komisioni, afati prej tre vjetësh i përmendur në paragrafin 1 mund të zgjatet deri në pesë vjet, në pajtim me nenin 34(2) të Marrëveshjes Sektoriale.

Afatet faktike për anulimin e pjesëve tregohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

PJESA II

CAKTIMI I DETYRAVE PËR ZBATIMIN E BUXHETIT

Neni 6

Caktimi i detyrave për zbatimin e buxhetit

1. Komisioni i cakton Shqipërisë detyrat e zbatimit të buxhetit për masat e mëposhtme të Programit IPARD II:

- Investim në asetet fizike të njësive bujqësore;
- Investime në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;
- Diversifikimi fermer dhe zhvillimi biznesit.

2. Detyrat e zbatimit të buxhetit të përcaktuara në paragrafin 1 caktohen dhe zbatohen në bazë të strukturave, organeve dhe autoriteteve të mëposhtme të caktuara nga Shqipëria:

- a) Koordinatori Kombëtar IPA (NIPAC);
- b) Zyrtari Autorizues Kombëtar (NAO);
- c) Zyra Mbështetëse NAO (NAO SO);
- d) Fondi Kombëtar (NF);
- e) Autoriteti Menaxhues (MA)
- f) Agjencia IPARD (IA);
- g) Autoriteti i Auditimit (AA).

Neni 7

Kushtet

1. Pa cenuar kushtet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër, Marrëveshjen Sektoriale dhe Programin IPARD II, caktimi i detyrave për zbatimin e buxhetit të specifikuar në nenin 6, u nënshtrohet kufizimeve dhe kushteve të mëposhtme:

i) Thirrjet për aplikime sipas IPARD II nuk duhet të bëhen para se DG AGRI të ketë verifikuar dhe njohur me letër zyrtare që:

a) Një numër i mjaftueshëm personeli është rekrutuar dhe trajnuar siç duhet në departamentin përgjegjës për miratimin e aplikimeve dhe kontraktimin në Agjencinë IPARD për të garantuar trajtimin në kohë të kërkesave për ndihmë;

b) Komiteti i vlerësimeve është ngritur sipas rregullave, me qëllim që të verifikojë arsyeshmërinë e shpenzimeve;

c) Struktura e Autoritetit të Auditimit dhe kapaciteti i auditimit të jetë stabilizuar dhe konfirmuar.

ii) Angazhimet me përfituesit (kontratat), sipas IPARD II, nuk duhet të nënshkruhen derisa DG AGRI të ketë verifikuar dhe njoftuar me letër zyrtare, që:

a) Një numër i mjaftueshëm personeli është rekrutuar dhe trajtuar siç duhet në Departamentin përgjegjës për kontrollin në terren dhe autorizimin e pagesave në agjencinë IPARD për të garantuar trajtimin në kohë të kërkesave për ndihmë dhe pretendimet për pagesa;

b) Programet kompjuterike të kontabilitetit janë përshtatur me kërkesat e IPARD II.

iii) Pa cenuar asnjë dispozitë specifike në Marrëveshje, asnjë pagesë nuk kryhet në favor të një kërkuesi ose të caktuarit e tyre për të cilët është vërtetuar se ata kanë krijuar artificialisht kushtet e kërkuara për përfundimin e këtyre pagesave, me qëllim përfundimin e një avantazhi në kundërshtim me objektivat e mbështetjes.

2. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të parashikuara në nenin 59(2)(a) të Marrëveshjes Kuadër, NAO përdor formularët e parashikuar në shtojcat 6 dhe 9 të Marrëveshjes Sektoriale sipas specifikimit në nenin 45 të Marrëveshjes Sektoriale.



Neni 8

Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Pa cenuar asnjë rregull tjetër pranueshmërie të përcaktuar në Marrëveshjen Kuadër, Marrëveshjen Sektoriale dhe Programin IPARD II, zbatohen rregullat për pranueshmërinë e shpenzimeve të propozuar nga Shqipëria në letër nr. 4848/prot., të datës 20 korrik 2017, të regjistruar në komision me referencën Ares (2017)6125895 dhe çdo ndryshim tjetër i mëvonshëm i këtyre rregullave të miratuara nga Komisioni.

2. Data e fundit e pranueshmërisë për shpenzimet sipas Programit IPARD II është 31 dhjetor 2023.

Neni 9

Pezullimi ose anulimi i pjesëve të Marrëveshjes Financiare

Marrëveshja Financiare nuk ndikon në asnjë vendim që mund të marrë Komisioni sipas Marrëveshjes Kuadër dhe Marrëveshjes Sektoriale, duke përfshirë, pa kufizim, ndërprerjen dhe pezullimin e pagesave dhe korigjimeve financiare.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën e fundit nga Palët njofton Palën tjetër me shkrim në lidhje me miratimin e saj, në pajtim me legjislacionin e brendshëm në fuqi ose procedurën e Palës.

Neni 11

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në Tiranë, më

Nënshkruar për Komisionin Evropian në emër të Bashkimit Evropian, në Bruksel, më

Z. Jerzy Plewa

Drejtor i Përgjithshëm për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

SHTOJCË

Shumat treguese maksimale vjetore për kontributin vjetor të BE-së, sipas fushës së IPA II të politikës për bujqësinë dhe politikën e zhvillimit për vitet 2014–2020 (IPARD II) (në EUR) (zëri i buxhetit 05.05 03)

Kontributi vjetor për Programin IPARD II (në euro)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019 shumëtreguese	2020 shumëtreguese
Totali IPARD II	--	--	13 000 000	14 000 000	12 000 000	16 000 000	16 000 000

Shpenzimet treguese të plota për zbatimin e Programit IPARD II në Shqipëri, duke përfshirë kontributet e BE-së, kombëtare dhe private, për periudhën 2014–2020 është 161 milionë euro.

Kontributi tregues i BE-së është 71 milionë euro.

Afatet faktike për pjesët e mbetura të buxhetit përcaktohen si më poshtë: Pjesa e buxhetit të vitit 2016 duhet të shpenzohet deri më 31.12.2019.

Pjesa e buxhetit të vitit 2017 duhet të shpenzohet deri më 31.12.2020.

Pjesa e buxhetit të vitit 2018 duhet të shpenzohet deri më 31.12.2021.

Pjesa e buxhetit të vitit 2019 duhet të shpenzohet deri më 31.12.2022.

Pjesa e buxhetit të vitit 2020 duhet të shpenzohet deri më 31.12.2023.

**VENDIM****Nr. 245, datë 9.5.2018****PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT
2018, PËR BASHKËSITË FETARE QË
KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE
ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkë-sive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, nga buxheti i vitit 2018, prej 109 000 000 (njëqind e nëntë milionë) lekësh, miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, të përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 680 000 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të ndarë në:

i) 11 520 000 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 80 punonjës të administratës;

ii) 20 160 000 (njëzet milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 140 punonjës të institucioneve të arsimit para-shkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 776 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të ndarë në:

i) 20 016 000 (njëzet milionë e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 139 punonjës të administratës;

ii) 5 760 000 (pesë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institucioneve të arsimit para-shkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 776 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të ndarë në:

i) 6 336 000 (gjashtë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 44 punonjës të administratës;

ii) 19 440 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 135 punonjës të institucioneve të arsimit para-shkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 768 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, të ndarë në:

i) 3 744 000 (tre milionë e shtatëqind e dyzet e katër mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 26 punonjës të administratës;

ii) 15 024 000 (pesëmbëdhjetë milionë e njëzet e katër mijë) lekë, përkatësisht:

- 12 024 000 (dymbëdhjetë milionë e njëzet e katër mijë) lekë, për ndërtimin e Teqesë së Elbasanit;

- 3 000 000 (tre milionë) lekë, për ndërtimin e Teqesë së Shtufit, Gjirokastrë.

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë për shkak të pozitës së veçantë si Kryegjyshit Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoren për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2018, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, bëhet njëherësh, brenda muajit maj të vitit 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**VENDIM**

Nr. 247, datë 9.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 400, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT EVROPIAN, ME MISION TRAJNUES, NË REPUBLIKËN E MALIT, NË AFRIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 1, data “...30 qershor 2018...” ndryshon dhe bëhet “...31 dhjetor 2019...”;

b) Në pikën 3, data “...30 qershor 2018...” ndryshon dhe bëhet “...31 dhjetor 2019...”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 248, datë 9.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 440, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AKADEMISË SË SHKENCave”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8, pika 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 440, datë 16.5.2005, të Këshillit të Ministrave, nga prona me emërtimin “Akademia e Shkencave, Tiranë”, me numër rendor 8, të hiqet komponenti përbërës me emërtimin “Fondi i librave, magazinë”, me sipërfaqe të përgjithshme 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Akademia e Shkencave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Institucioni/Pushtetit Qendror: **Akademia e Shkencave**

Bashkia: **Tirane**

Fusha e perdorimit te Prones: **Administrative**

Supervizoi: **Florian Progni (Specialist)**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Fadil Kepi (Shef i Sek. te Pergj. te Ak. Shkencave)**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Veni ndodhja / Shtrinja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vendi ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ² ose mi	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
8			Akademia e Shkencave Tirane		Sheshi "Fan Noli"	1128.25		Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Salla e mbledhje		180	Administrative	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Zyre dhe garazhe		299.25	Administrative Ambjente ndihmese	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	
				Godina e re Enciklopedia		352	Administrative	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	Ndertese dy kate
				Fondi i librave magazine		297	Ambjente ndihmese	Akademia e Shkencave	Akademia e Shkencave	

**VENDIM****Nr. 249, datë 9.5.2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 763, DATË 2.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NGJYRËS, SHENJAVE DHE PËRDORIMIN E MJETEVE TË POLICISË SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 100, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në faqen nr. 6, të katalogut të lidhjes nr. 1, “Ngjyra dhe disenjo e mjeteve të uniformuara të Policisë së Shtetit”, bashkëlidhur vendimit nr. 763, datë 2.11.2016, të Këshillit të Ministrave, të hiqen përmasat e shprehura në numrat 2480, 3880, 1410 dhe 1670.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 250, datë 9.5.2018****PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDEVE TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT NË DISA NJËSI TË QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2018, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajona-le”, rishpërndahen në disa institucione qendrore, që janë autoritete kontraktuese, për financimin e projekteve në vazhdim të infrastrukturës vendore, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 2 dhe Agjencia për Zhvillimin Rajonal 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Tabela nr. 1. Rishpërndarja e fondeve buxhetore për projektet në vazhdim të FZHR-së, për njësitë qendrore

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Autoriteti kontraktues	Kap.	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i D. së Thesarit	Kodi i projektit	Emri i projektit	Debiti
			PAKËSOHET							213.251.929
001	56	1056001	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	01	06220	2310000	3535	M560443	Infrastruktura vendore dhe rajonale	213.251.929
			SHTOHET							213.251.929
001	87	1087024	AZHR 3	01	01150	2310000	3535	M870208	Rigjallërimi i vlerave historike, kulturore e turistike të Zonës së Zhvillimit Rajonal 3, Korçë, Elbasan (3 lote)	83.325.107
001	87	1087021	AZHER	01	01150	2310000	3535	M870209	Qendër multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja	39.701.753
001	87	1087023	AZHR 2	01	01150	2310000	3535	M870207	Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse Qafë-Shtamë (Bashkia Krujë) - Burrel (Bashkia Mat), me qëllim promovimin e atraksioneve turistike të Parkut Kombëtar të Qafë-Shtamës (loti 2.1). (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)	90.225.069



VENDIM

Nr. 251, datë 9.5.2018

**PËR MIRATIMIN E
LETËRMARRËVESHJES, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË
VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE TË GRANTIT TË SIGURUARA
NGA SEKRETARIATI I SHTETIT PËR
ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO) TË
QEVERISË ZVICERANE, NËN FONDIN
E BESIMIT ME SHUMË DONATORË,
PËR FUQIZIMIN E KONTABILITETIT
DHE TË MJEDISIT TË MIRËBESIMIT
NË EVROPËN JUGORE DHE AZINË
QENDRORE, PËR PROJEKTIN E
ZHVILLIMIT TË KONTABILITETIT NË
SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të qeverisë zvicerane, nën Fondin e Besimit me Shumë Donatorë, për fuqizimin e kontabilitetit dhe mjedisit të mirëbesimit në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, për projektin e zhvillimit të kontabilitetit në sektorin publik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

BANKA BOTËRORE

IBRD • IDA I GRUPI I BANKËS BOTËRORE

7 nëntor 2017

Shkëlqesisë së tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: **SAFE Granti nr.TFOA3277 (pjesa A)**
SAFE Granti nr.TFOA5134 (pjesa B)
Shqipëria — Zhvillimi i një projekti
kontabiliteti në sektorin publik

LETRA E MARRËVESHJES

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të kryer në emër të Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), duke vepruar si administratore e fondeve të grantit të dhëna nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (“SECO”) të qeverisë zvicerane (“Donatorët”), sipas Fondit të Trustit me shumë Donatorë për Fuqizimin e Llogaridhënies dhe Mjedisit në Mirëbesim në Evropën Jugore dhe Azinë Qendrore, propozon që t’i japë Marrësit një grant (“Granti”) në dy pjesë si vijon, për të asistuar në financimin e Zhvillimit të Projektit për Kontabilitetin e Sektorit Publik, siç përshkruhet në shtojcë (“Projekti”):

a) një shumë që nuk tejkalon një milion e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind dollarë amerikanë (1,073,500 \$) (“Pjesa A e Grantit-TFOA3277”); dhe

b) një shumë që nuk tejkalon treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind dollarë amerikanë (376,500 \$) (“Pjesa B e Grantit-TFOA5134”),

me kushtet dhe afatet e parashtruara ose të referuara në këtë letër marrëveshje (“Marrëveshja”), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur.

Ky Grant financohet nga trusti i lartpërmendur për të cilin Banka Botërore merr kontributet periodike nga Donatorët. Në përputhje me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përkufizohet në aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e pagesës së Bankës Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara në shumën e



fondeve të vëna në dispozicion të saj nga Donatorët sipas fondit të trustit të lartpërmendur dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr shumën e Grantit i nënshtrohet vënies në dispozicion të këtyre fondeve.

Marrësi përfaqëson, duke konfirmuar pranimin e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje për të realizuar Projektin në përputhje me kushtet dhe afatet e para-shtuara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni pranimin e Marrësit në lidhje me Marrëveshjen e lartpërmendur duke nënshkruar, shënuar datën dhe duke na kthyer kopjen bashkëlidhur të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Banka Botërore dërgon njoftimin e marrjes së njoftimit të Marrësit mbi përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për efektivitetin e saj sipas legjislacionit të Marrësit.

Me respekt,

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

nga

(nënshkrimi)

Maryam Salim

Menaxhere e vendit

Zyra e Bankës Botërore, Tiranë, Republika e

Shqipërisë

PRANUAR:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: ARBEN AHMETAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Datë: 3.4.2018

Dokumente bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fondet e ndryshme, datë 15 shkurt 2012.

2. Letra e disbursimit e së njëjtës datë si e kësaj Marrëveshjeje, së bashku “Udhëzimet e disbursimit për financimin e Projektit të investimit”, muaji shkurt 2017.

3. Rregullorja e prokurimit e Bankës Botërore për Huamarrësit në kuadrin e financimit të Projektit të investimeve, datë 1 korrik 2016.

4. Udhëzime për parandalimin dhe luftën ndaj mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kreditë e BERZH-it dhe kredi-timet e grantet IDA, datë 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016.

SAFE Granti nr. TFOA3277

SAFE Granti nr. TFOA5134

SHTOJÇË

Neni 1

Kushtet standarde; përkufizimet

I.01 Kushtet standarde. Kushtet atandarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fondet e ndryshme të datës 15 shkurt 2012 (“Kushtet standarde”) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

I.02 Përkufizimet. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termit me germa kapitale që përdoren në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë atribuuar atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje.

a) “CFCU” nënkupton Njësine Qendrore të Financës dhe Kontraktimit në kuadrin e Mini-strisë së Financave dhe Ekonomisë të Marrësit ose të cilitdo pasardhësi të tij.

b) “MOFE” nënkupton Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Marrësit ose të cilitdo pasardhës të tij.

c) “IPSAS” nënkupton standardet e kontabilitetit për sektorin publik ndërkombëtar.

d) “Kostot operative” nënkupton kostot e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka Botërore, për shpenzimet shtesë të shkaktuara për llogari të zbatimit të Projektit, të cilat konsistojnë në funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjetit, kostot e komunikimit dhe sigurimeve, tarifatat bankare, mirëmbajtjen e zyrës (dhe pajisjeve të zyrës), shërbimet, fotokopjimi/printimi i doku-menteve, mallrat e konsumit, kostot e udhëtimit dhe në ditë për personelin e projektit për udhëtime që lidhen me zbatimin e Projektit.

e) “EPF” nënkupton Raportin për Përmirësimin e Raportimit Financiar Publik.

f) “Trajnim” nënkupton kostot e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka Botërore, për trajnimet që zhvillohen në kuadër të Projektit, duke përfshirë



kostot e mësimdhënies, udhëtimeve dhe jetesës për pjesëmarrësit në trajnim, kostot që lidhen me sigurimin e shërbimeve të trajnuesve, qiranë e ambienteve të trajnimit, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe kostot e tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgatitjen dhe zbatimin e kursit të trajnimit (por duke përjashtuar mallrat dhe shërbimet e konsulencës).

g) “PSC” nënkupton Komitetin Drejtues të Projektit, të referuar në seksionin 2.03 (b) të kësaj Marrëveshjeje ose çdo pasardhës i tij i pranueshëm për Bankën Botërore.

h) “PIT” nënkupton Ekipin për Zbatimin e Projektit të referuar në seksionin 2.03 (a) ose çdo pasardhës i tij i pranueshëm për Bankën Botërore.

Neni 2 Zbatimi i Projektit

2.01 Objektivat e Projektit dhe zbatimit. Objektivat e Projektit, janë: (a) hartimi i një skeme për zbatimin e kontabilitetit të akumuluar për sektorin publik; dhe (b) mbështetja e fazave të para të zbatimit të kësaj skeme, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve teknike thelbësore. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Përgatitja e Raportit Financiar dhe të Kontabilitetit për Sektorin Publik në përputhje me IPSAS

1. Përgatitja e Planit të Strategjisë për Zbatimin e IPSAS-it

Dhënia e mbështetjes për përgatitjen e një plani strategjik për zbatimin e IPSAS-it, i cili konsiston në: (i) metodologjinë e detajuar të zbatimit (e drejtpërdrejtë kundrejt të tërthortë), qëllimin dhe kohën; (ii) projektin e detajuar dhe planet për menaxhimin e ndryshimeve; (iii) planin e komunikimit dhe shpërndarjes; dhe (iv) planin e trajnimit.

2. Zhvillimi i kuadrit rregullator, ligjor dhe kontabël në sektorin publik

Dhënia e mbështetjes për zhvillimin e standardeve kontabël në sektorin publik në përputhje me IPSAS-në, duke përfshirë: (i) përkthimin e IPSAS-së në gjuhën shqipe; (ii) zhvillimin dhe miratimin e legjislacionit kontabël vendas; dhe (iii) hartimin e një udhëzuesi për zbatimin në nivel kombëtar.

3. Shqyrtimi dhe ndryshimi i Skemës Kombëtare të Llogarive

Dhënia e mbështetjes për të shqyrtuar dhe

ndryshuar, nëse është e nevojshme, skemën kombëtare të llogarive për t'u harmonizuar me nevojat e kontabilitetit, buxhetimit dhe statisti-kore.

4. Zbatimi gradual i standardeve të kontabilitetit në sektorin publik në përputhje me IPSAS-në

Dhënia e mbështetjes për MOFE-në në lidhje me: (i) aktivitetet për menaxhimin e ndryshimeve që lidhen me zbatimin e standardeve të përzgjedhura nga IPSAS-i, në përputhje me qëllimin e planit të strategjisë për zbatimin e IPSAS-it; (ii) zbatimin e standardeve të përzgjedhura nga IPSAS-i, në përputhje me qëllimin e Planit Strategjik për Zbatimin e IPSAS-it; dhe (iii) trajnimin e nëpunësve të financës për zbatimin e standardeve të reja të kontabilitetit.

Pjesa B. Zhvillimi i kapaciteteve MOFE dhe aftësive profesionale në kontabilitet për personelin e përzgjedhur publik të kontabilitetit

1. Fuqizimi i kapaciteteve teknike

Dhënia e mbështetjes për fuqizimin e kapaciteteve teknike dhe aftësive profesionale në kontabilitet në kuadrin e MOFE-së, nëpërmjet: (i) përcaktimit të përgjegjësive institucionale për metodologjinë dhe zbatimin e kontabilitetit në sektorin publik; dhe (ii) përgatitjen e një plani pune për njësitë në kuadrin e MOFE-së përgjegjëse për kontabilitetin.

2. Zhvillimi i aftësive profesionale të kontabilitetit dhe një mekanizmi të qëndrueshëm trajnimi në kontabilitet në sektorin publik

Dhënia e mbështetjes për zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve kontabël në sektorin publik, nëpërmjet: (i) trajnimit të oficerëve të përzgjedhur financiarë nga entet e sektorit publik për t'i bërë ata të pranueshëm për të marrë vërtetime të njohura në nivel ndërkombëtar në raportimin financiar dhe kontabël në sektorin publik; (ii) trajnimit të një numri të përzgjedhur trajnuesish në raportimin financiar dhe kontabël në sektorin publik; dhe (iii) krijimin e një programi certifikimi dhe trajnimi në raportimin financiar dhe kontabël në një institucion vendor.

Pjesa C: Mbështetja për zbatimin e Projektit

Dhënia e mbështetjes për MOFE-në dhe CFCU-në, për: (a) zbatimin e Projektit, duke përfshirë administrimin, auditimet, prokurimin, menaxhimin financiar dhe aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit; dhe (b) aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve për personelin e përfshirë në zbatimin e Projektit për tema të lidhura në



mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e Projektit.

2.02 Zbatimi i Projektit në vija të përgjithshme. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të realizojë Projektin në përputhje me dispozitat e: (a) nenit II të kushteve standarde; (b) “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën ndaj mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kreditë e BERZH-it dhe kreditimet e grantet IDA”, datë 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016 (“Udhëzimet antikorrupsion”); dhe (c) këtë nen.

2.03 Masa institucionale dhe të tjera. Për qëllime të realizimit të Projektit, Marrësi:

a) Do të krijojë dhe mbajë, gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Ekip për Zbatimin e Projektit (“PIT”), me burimet e përshtatshme, personelin profesional në numër të duhur dhe funksionet e përgjegjësitë e pranueshme për Bankën Botërore, për të qenë përgjegjës për zbatimin e Projektit në koordinim me CFCU-në dhe PSC-në.

b) Do të krijojë dhe mbajë, gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit (“PSC”), i cili përbëhet nga përfaqësues të MOFE-së, CFCU-së dhe autoritete të tjera përkatëse, me mandat, terma reference dhe burime të pranueshme për Bankën Botërore, për të qenë përgjegjës për dhënien e udhëzimeve strategjike për t’i dhënë prioritet aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë miratimin e planeve të punës dhe mbikëqyrjen e progresit të zbatimit të Projektit.

c) Nëpërmjet PIT-it dhe CFCU-së do të miratojë dhe realizojë Projektin në përputhje me dispozitat e një manuali (“Manuali i Operacioneve”) të pranueshëm për Bankën Botërore, i cili do të përfshijë, ndër të tjera: (a) një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të Projektit dhe masave institucionale për Projektin; (b) procedurat administrative, kontabël, audituese, raportuese, financiare (duke përfshirë aspektet e qarkullimit monetar në lidhje me të), prokurimin dhe disbursimin e Projektit; dhe (c) treguesit e monitorimit për Projektin. Në rast se cilado dispozitë e Manualit të Operacioneve do të jetë në kundërshtim me çfarëdo dispozite sipas kësaj Marrëveshjeje, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi. Manuali i Operacioneve mund të ndryshohet herë pas here vetëm me miratimin paraprak me shkrim të Bankës Botërore.

d) Do të sigurojë se CFCU-ja përmbush të gjitha detyrimet e besuara që lidhen me zbatimin e Projektit, duke përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin dhe raportimin, të gjitha në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2.04 Transparenca dhe vizita e donatorëve.

a) Marrësi, nëpërmjet PIT-it, do të marrë ose do të angazhojë që të merren të gjitha ato masa që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e Donatorëve për Projektin.

b) Për qëllimet e seksionit 2.09 të kushteve standarde, Marrësi, nëpërmjet PIT-it, me kërkesë të Bankës Botërore, do t’u japë mundësi përfaqësuesve të Donatorëve që të vizitojnë çdo pjesë të territorit të Marrësit për qëllime që lidhen me Projektin.

2.05 Monitorimi i Projektit, raportimi dhe vlerësimi.

a) Marrësi, nëpërmjet PIT-it, do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatisë raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport Projektit do të mbulojë periudhën e një gjashtëmujori kalendarik dhe do të dorëzohet te Banka Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës që mbulohet nga ky raport.

b) Marrësi, nëpërmjet PIT-it, do të përgatisë Raportin e Përfundimit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti i Përfundimit do t’i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.06 Menaxhimi financiar.

a) Marrësi, nëpërmjet CFCU-së, do të sigurojë se mirëmbahet një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi, nëpërmjet CFCU-së, do të sigurojë që të përgatiten raporte financiare të pjesshme të paaudituar për Projektin dhe t’i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi, nëpërmjet CFCU-së, do të ketë pasqyrat financiare të audituara në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të kushteve standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare



do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Marrësit. Pasqyrat e audituara financiare për çdo periudhë të tillë do t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të asaj periudhe.

2.07 Prokurimi. Të gjitha mallrat, shërbimet e jokonsulencës dhe shërbimet e konsulencës të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga shuma e Grantit do të prokurohen në përputhje me kriteret e parashtruara ose të referuara në “Rregulloren e prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit në kuadrin e financimit të Projektit të investimeve” e datës 1 korrik 2016 dhe dispozitat e planit të prokurimit të Marrësit për Projektin (“Plani i prokurimit”), të datës 10 prill 2017, të dhëna në seksionin IV të rregullores së Prokurimit, pasi mund të përditësohen herë pas here në marrëveshje me Bankën Botërore.

Neni 3

Tërheqja e shumës së grantit

3.01 Shpenzimet e pranueshme. Marrësi mund të tërheqë shumën e Grantit në përputhje me dispozitat e: (a) kushteve standarde; (b) këtë seksion; dhe (c) udhëzime shtesë që mund të specifikojë Banka Botërore me njoftim për Marrësin (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projekte”, të muajit shkurt 2017, siç është rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe siç zbatohet në këtë Marrëveshje në vijim të këtyre udhëzimeve), për të financuar shpenzimet e pranueshme, siç parashtrohen në tabelën që vijon. Tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga shuma e Grantit (“kategoria”), shpërndarjet e shumave të Grantit në çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e pjesës A të Grantit TF0A3277 (shprehur në \$)	Shuma e pjesës B të Grantit - TF0A5134 (shprehur në \$)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (duke përfshirë taksat)
I. Mallra, shërbime konsulence, kosto trajnimi dhe operacionale të Projektit	1,073,500	376,500	100%
SHUMA TOTALE	1 073 500	376 500	

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje,

nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesa të kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e referuar në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 30 qershor 2020.

Neni 4

Përfaqësuesi i Marrësit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit, i referuar në seksionin 7.02 të kushteve standarde, është ministri i tij i Financave dhe Ekonomisë.

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit e referuar në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë

Republika e Shqipërisë
Faksimile: +355 4 222 8405

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e referuar në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

International Bank for Reconstruction and Development (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim)

1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Faksimile: 1-202-477-6391

VENDIM

Nr. 252, datë 9.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRBLIMIN E KRYETARIT, ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TEKNIK TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 189/e, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari, anëtarët dhe sekretari i këshillit mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të



Pronësisë Industriale (DPPI) përfitojnë një shpërblim kundrejt pjesëmarrjes në mbledhje, përkatësisht:

- a) kryetari me 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë;
- b) anëtarët me 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
- c) sekretari me 3 000 (tre mijë) lekë.

Në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të këshillit.

2. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, të anëtarëve dhe të sekretarit teknik të këshillit mbikëqyrës, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentacionit që provon pjesëmarrjen në mbledhje, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 253, datë 9.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 182, DATË 25.2.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR
PËRZGJEDHJEN E RREGULLUESIT
KRYESOR (LEAD MANAGER) DHE/OSE
HUADHËNËSIT PËR REALIZIMIN E
HUAMARRJES ME INSTRUMENTE
FINANCIARE NË TREGUN E HUAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të nenit 7, shkronja “ç”, dhe të paragrafit të dytë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 182, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 2, 7 e 8, fjalët “... struktura përgjegjëse për huamarrjen...”, zëvendësohen me “... struktura përgjegjëse për borxhin publik, në bashkëpunim me struktura të tjera të ministrisë përgjegjëse për financat ...”;

b) Kudo ku referohet emërtesa “Ministria e Financave”, zëvendësohet me “ministria përgjegjëse për financat”, si dhe kudo tjetër, përveç shkronjës “a” të këtij vendimi, ku referohet “struktura përgjegjëse për huamarrjen”, zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për borxhin publik”;

c) Në pikën 3, shkronja “c”, në fund të fjalisë shtohet fjala “të ndryshuar”;

ç) Fjalja e parë e pikës 6 zëvendësohet me fjalinë me këtë përmbajtje:

“Pas dorëzimit zyrtar në protokollin e ministrisë përgjegjëse për financat të propozimeve nga institucionet e interesuara, struktura përgjegjëse për borxhin publik në ministrinë përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me struktura të tjera të kësaj ministrie, fillon vlerësimin e tyre.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 254, datë 9.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 58, DATË 21.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRAJTIMIN E DISA FAMILJEVE QË
PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“LIDHJA E RRUGËS
TRANSBALLKANIKE ME
SUPERSTRADËN FIER-VLORË”
ME PROGRAME SOCIALE TË
STREHIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 58, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, fjalët “... përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë për një periudhë trevjeçare ...”, zëvendësohen me “... ”.



përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin ...”.

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1. dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1 Financimi i qirasë për familjet përfituese për vitin 2018 të mbulohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Për periudhën në vijim, financimi i nevojshëm të mbulohet 50% nga buxheti i shtetit që akordohet për strehimin, dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

1.2 Financimi i qirasë të bëhet pas verifikimit nga Bashkia Vlorë të gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes, sipas parashikimeve të ligjit për strehimin.”.

c) Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për strehimin”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 255, datë 9.5.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES
STRUKTURE E TË SHPËRBLIMIT
TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
LARTË TË SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes strukturore të Këshillit të Lartë të Sportit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sportin dhe ka në përbërje të tij 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë vijon:

a) Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë anëtar;

b) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Futbollit anëtar;

c) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Basketbollit anëtar;

ç) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Volejbollit anëtar;

d) Përfaqësuesi i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit anëtar;

dh) Dy përfaqësues nga biznesi anëtar;

e) Tri personalitete të sportit anëtarë;

ë) Një jurist anëtar;

f) Një gazetar sportiv anëtar;

g) Një specialist nga MASR-ja sekretar.

2. Përbërja nominative e Këshillit të Lartë të Sportit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

3. Këshilli i Lartë i Sportit thirret si rregull nga ministri përgjegjës për sportin, jo më pak se 3 (tri) herë në vit.

4. Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit.

5. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Sportit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

6. Vendimi nr. 437, datë 2.7.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të Këshillit Kombëtar të Sportit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 256, datë 9.5.2018

**PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT
FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë, kategoria parësore, sipas



listës “Aneksi A - Dënim me burg, izolim në hetuesi, izolim në institucion mjekësor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Masa e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të bëhet me këste, sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

3. Shuma e llogaritur të transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në

llogaritë personale të tyre, të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2017, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKSI A
DËNIM ME BURG, IZOLIM NË HETUESI, IZOLIM NË INSTITUCION MJEKËSOR

Nr.	Nr. i dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme Ministria e Financave		Enti Kombëtar i Banesave	Z.Q.R.P.P	Dëmshpërblimi përfundimtar
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	1128	19.02.2008	Faslli	Guni	Sali	Fatime	14.09.1947	Tiranë	M	Dënimi parë: 7 muaj 9 ditë Dënimi dytë: 10 muaj	1,072,000	200,000	720,000	0	0	152,000
2	2551	04.03.2008	Shkelqim	Kapllani	Hasan	Fatime	09.08.1933	Skrapar	M	10 vjet	6,084,000	100,000	1,197,600	1,505,678	0	3,280,722
3	3301	11.03.2008	Seit	Labi	Braho	Zulë	28.02.1941	Konispol, Sarandë	M	1 vit 9 muaj 12 ditë	1,312,000	200,000	720,000	0	0	392,000
4	12546	22.07.2008	Ronalt (Ronald)	Papa	Aristotel	Vullnete	21.10.1952	Tiranë	M	Dënimi parë: 3 vjet 8 muaj 1 ditë Dënimi dytë: 8 muaj 12 ditë	3,208,000	441,205	441,205	0	0	2,325,590
5	15294	13.11.2008	Fatmir	Selmanaj	Mystehak	Hamite	25.10.1963	Vlorë	M	1 muaj 25 ditë	112,000	0	103,355	0	0	8,645
6	21595	13.05.2010	Nexhat	Gjeçi	Maksud	Bakushe	05.05.1944	Lekaj, Durrës	M	14 vjet 2 muaj 8 ditë	10,360,000	200,000	1,600,000	0	0	8,560,000
7	21597	10.04.2011	Vasil	Nikdhuma	Mitro	Kalopi	03.04.1943	Piqeras, Sarandë	M	3 vjet 2 muaj 19 ditë	2,352,000	0	1,897,073	0	0	454,927
8	21600	03.04.2017	Osman	Çyrçiali	Muharem	Zinete	31.01.1946	Tiranë	M	6 vjet 10 muaj 7 ditë	5,014,000	0	822,575	0	0	4,191,425
9	21601	31.03.2017	Agim	Kongjonaj	Dervish	Shano	11.05.1958	Tiranë	M	1 vit 11 muaj 14 ditë	1,278,000	0	120,000	0	0	1,158,000
10	21606	11.12.2012	Selim (Bashkim)	Gepeli (Çepeli)	Shaziman	Ismete	03.06.1958	Durrës	M	4 vjet 8 muaj 25 ditë	3,466,000	0	530,000	0	0	2,936,000
11	21607	11.12.2012	Ylli	Nino	Petro	Vasilika	21.02.1954	Tiranë	M	3 vjet 5 muaj 8 ditë	2,516,000	0	413,260	2,531,000	0	0
12	21609	26.02.2010	Pëllumb	Zotaj	Dule	Bule	17.06.1952	Tiranë	M	5 vjet 6 muaj 19 ditë	3,608,000	0	0	893,000	0	2,715,000
13	21610	03.03.2017	Paulin	Malaj	Pashko	Dilë	20.03.1962	Ivanaj, Shkodër	M	8 muaj 5 ditë	506,000	0	0	0	0	506,000
14	21612	06.09.2016	Paulin	Ndoja	Rrok	Çile	26.05.1968	Stajkë, Shkodër	M	2 vjet 4 muaj 7 ditë	1,198,000	0	0	0	0	1,198,000
15	21613	13.02.2017	Skënder	Fejzulla	Gani	Sheriban	11.12.1963	Fier	M	8 muaj 27 ditë	550,000	0	0	0	0	550,000
16	21614	14.10.2016	Muharem	Qerimi	Adem	Hava	27.05.1958	Tiranë	M	1 vit 7 muaj 27 ditë	1,218,000	200,000	720,000	0	0	298,000
17	21615	26.04.2016	David	Lumaj	Gjekë	Gjyste	01.11.1959	Dedaj, Shkodër	M	7 muaj 28 ditë	490,000	0	0	0	0	490,000
18	21616	02.11.2015	Avdi	Bajra	Vath	Nife	07.11.1941	Gjuricaj, Durrës	M	10 vjet 8 muaj 9 ditë	2,942,000	83,507	1,200,000	0	0	1,658,493
19	21620	02.09.2011	Ahmet	Suçi	Hazis	Rute	05.02.1931	Macukull, Mat	M	1 vit 3 muaj 22 ditë	960,000	200,000	478,301	0	0	281,699
20	21625	30.12.2009	Ermira	Kullau	Ramiz	Naile	25.06.1967	Tiranë	F	2 vjet 9 muaj 6 ditë	1,014,000	0	0	0	0	1,014,000
21	21628	10.09.2009	Stavro	Lito	Loli (Jorgo)	Dhimitrulla	28.09.1948	Finiq, Sarandë	M	14 vjet 4 muaj 26 ditë	10,520,000	0	1,727,644	0	0	8,792,356
22	21630	29.09.2009	Gëzim	Mulletja	Bedri	Dylbere	27.06.1954	Tiranë	M	5 vjet	3,650,000	0	597,041	0	0	3,052,959
23	21632	14.04.2014	Fatmir	Shemshiri	Hamza	Hamide	04.03.1958	Tiranë	M	6 muaj 17 ditë	270,000	0	0	0	0	270,000
24	21633	16.09.2011	Hamiç	Milushi	Sadik	Rabi	10.10.1925	Markaj, Tropojë	M	10 muaj 12 ditë	644,000	0	0	0	0	644,000
25	21637	31.03.2017	Amlet	Kyçyku	Meleq	Fatmire	27.02.1958	Korçë	M	9 muaj 5 ditë	568,000	0	170,000	0	0	398,000
26	21638	18.03.2014	Mark	Pjetri	Pjetër	Dile	17.11.1964	Lezhë	M	2 vjet 1 muaj 23 ditë	1,132,000	0	260,000	0	0	872,000
27	21639	18.04.2011	Agron	Luke	Xhevat	Makbule	04.04.1953	Libohovë	M	10 vjet 6 muaj 21 ditë	3,428,000	0	1,125,699	0	0	2,302,301
28	21640	12.04.2010	Agim	Rrubiega (Kollçaku)	Ramazan	Hamide	09.02.1956	Kavajë	M	4 vjet 2 muaj 6 ditë	3,056,000	0	500,000	0	0	2,556,000
29	21641	31.07.2012	Hamza	Ademi	Jasim	Zuliha	14.03.1961	Reres, Fier	M	9 muaj	558,000	0	0	0	0	558,000
30	21645	15.03.2011	Islam	Kora	Hasan	Zyra	23.06.1955	Tiranë	M	1 vit 10 muaj 17 ditë	1,384,000	0	224,548	0	0	1,159,452
31	21646	07.01.2010	Fadli	Varvarica	Eqrem	Emine	04.12.1943	Tiranë	M	1 vit 9 muaj 10 ditë	1,308,000	0	213,370	0	0	1,094,630
32	21649	22.07.2009	Faik	Suli	Hasan	Xharie	23.05.1958	Kastriot, Dibër	M	4 vjet 4 muaj 12 ditë	3,192,000	0	500,000	0	0	2,692,000
33	21650	14.07.2009	Nino (Nuredin)	Lila (Bishani)	Çomo	Hyrre	03.03.1961	Kurjan, Fier	M	3 vjet 7 muaj 19 ditë	2,662,000	0	436,932	0	0	2,225,068
34	21651	16.10.2009	Venemin	Ranxha	Aleksandër	Zarifë	10.08.1954	Elbasan	M	7 vjet 2 muaj 16 ditë	5,266,000	0	1,200,000	0	0	4,066,000
35	21652	19.02.2016	Osman	Mema	Mehmet	Emine	10.04.1940	Helmas, Durrës	M	1 vit 6 muaj 17 ditë	1,136,000	0	200,000	0	0	936,000
36	21653	10.04.2015	Sokol	Hysaj	Miftar	Fatime	26.05.1948	Papaj, Tropojë	M	5 muaj 27 ditë	364,000	200,000	720,000	0	0	0
37	21655	27.10.2009	Kurt	Muslika	Tahir	Hate	08.05.1954	Tregtan, Kukës	M	14 vjet 6 muaj 16 ditë	4,250,000	0	1,070,000	0	0	3,180,000
38	21656	25.03.2014	Juljan	Berisha	Isuf	Prandvera	06.06.1968	Elbasan	M	1 vit 5 muaj 24 ditë	484,000	0	150,000	0	0	334,000
39	21658	21.01.2010	Besim	Tirana	Et-hem	Hatixhe	21.10.1966	Durrës	M	1 vit 1 muaj 10 ditë	812,000	0	1,200,000	0	0	0
40	21661	30.03.2012	Besnik	Likmeta	Aruç	Kimete	06.02.1955	Likmetaj, Durrës	M	9 muaj 5 ditë	568,000	200,000	720,000	0	0	0
41	21665	16.05.2013	Xhevdet	Kreka	Nevrus	Bukurije	03.10.1962	Tiranë	M	5 vjet 9 muaj 26 ditë	500,000	0	0	0	0	500,000
42	21666	27.05.2013	Aleksander	Vllasha	Ndoc	Marije	05.06.1950	Lekaj, Shkodër	M	7 vjet 4 muaj	5,358,000	0	800,000	0	0	4,558,000
43	21667	17.08.2011	Gëzim	Kuca	Hajredin	Bejushë	20.10.1955	Tiranë	M	5 vjet 9 muaj 5 ditë	3,012,000	0	700,000	0	0	2,312,000
44	21669	05.09.2013	Bore	Demaj	Mark	Zade	04.09.1960	Iballe, Pukë	F	1 vit 2 muaj 14 ditë	882,000	0	0	0	0	882,000
45	21670	02.04.2013	Sabri	Dom	Gani	Xhixhe	04.04.1962	Durrës	M	1 vit 10 muaj 18 ditë	1,386,000	0	250,000	0	0	1,136,000
46	21672	07.11.2011	Zef	Doçi	Quk (Çun)	Sutë	20.05.1925	Pukë	M	6 muaj 28 ditë	428,000	0	0	0	0	428,000



47	21677	20.08.2009	Pashko	Grishaj	Fran	Tone	14.08.1958	Vukel, Shkodër	M	2 vjet 6 muaj 14 ditë	1,714,000	0	330,000	0	0	1,384,000
48	21682	22.09.2010	Antonio (Kujtim)	Vezi	Hasan	Nuriçe	23.04.1966	Durrës	M	4 vjet 3 muaj 13 ditë	2,714,000	13,000	500,134	0	0	2,200,866
49	21683	07.02.2015	Vasari	Tabaku	Halit	Shahu	20.05.1946	Elbasan	M	10 vjet 6 muaj 11 ditë	3,410,000	0	1,000,000	0	0	2,410,000
50	21686	16.01.2015	Bashkim	Gjini	Baki	Fatime	03.01.1959	Lazarat, Gjirokastrë	M	9 muaj 7 ditë	520,000	0	0	0	0	520,000
51	21691	11.10.2009	Petrit	Shpuza (Ushitari)	Brahim	Elmaje	12.01.1967	Shkodër	M	2 vjet 8 muaj 1 ditë	1,958,000	0	0	0	0	1,958,000
52	21692	13.07.2010	Mitat	Alushi	Osman	Hyrrije	17.05.1954	Kavajë	M	9 vjet 3 muaj 20 ditë	5,522,000	0	1,671,063	0	0	3,850,937
53	21693	26.07.2010	Mico (Mico)	Guma	Pavlo	Vangjelia	12.01.1966	Himarë, Vlorë	M	5 vjet 1 muaj 29 ditë	3,770,000	0	0	0	0	3,770,000
54	21694	17.06.2011	Islam	Çuni	Sulejman	Mine	15.12.1944	Vlorë	M	8 vjet 11 muaj 23 ditë	6,568,000	0	800,000	0	0	5,768,000
55	21695	28.03.2014	Qamil	Rexhaj	Sahit	Hate	22.12.1957	Golaj, Kukës	M	7 vjet 10 muaj 14 ditë	2,440,000	0	700,000	0	0	1,740,000
56	21697	30.08.2010	Thodhori	Fili	Aleks	Katerina	07.08.1933	Mursi, Sarandë	M	7 vjet 7 muaj 12 ditë	5,568,000	100,000	813,658	0	0	4,654,342
57	21706	06.06.2012	Ardjan	Imeraj	Figjiri	Nazire	19.07.1963	Vlorë	M	8 muaj 26 ditë	548,000	0	0	0	0	548,000
58	21708	12.06.2012	Gani	Mani	Ymer	Zyli	07.10.1927	Shkodër	M	3 vjet 3 muaj	2,376,000	0	0	0	0	2,376,000
59	21713	04.09.2009	Fazli	Deliu (Zenuni)	Deli	Ajshe	06.09.1941	Çabër, Kosovë	M	Dënimi parë: 5 muaj 29 ditë Dënimi dytë: 18 vjet 5 muaj 25 ditë	10,010,000	0	0	0	0	10,010,000
60	21714	26.04.2010	Fatmir	Grifsha	Mahmud	Fatime	16.06.1970	Çerkez, Tiranë	M	2 vjet 4 muaj 27 ditë	1,370,000	0	289,315	0	0	1,080,685
61	21720	02.02.2011	Edmond	Proko	Albert	Aleksandra	20.06.1967	Fier	M	2 vjet 10 muaj 12 ditë	2,104,000	0	344,548	0	0	1,759,452
62	21722	06.08.2009	Leonidha	Ilupi	Mina	Gjena	04.01.1949	Fier	M	5 vjet 6 muaj 5 ditë	2,520,000	0	850,000	0	0	1,670,000
63	21723	21.12.2011	Sulejman	Alija	Lah	Miradje	21.05.1962	Lubishtë	M	7 vjet 9 muaj 14 ditë	5,696,000	0	0	0	0	5,696,000
64	21727	18.07.2014	Liman	Krasniqi	Rrahim	Hamide	05.03.1938	Terpezë, Prishtinë	M	2 vjet 10 muaj 20 ditë	2,120,000	50,000	346,521	0	0	1,723,479
65	21728	12.08.2009	Xheva	Toska	Veis	Gjyle	12.10.1947	Orizaj, Berat	M	11 vjet 5 muaj 22 ditë	8,584,000	0	1,378,192	0	0	7,005,808
66	21730	12.06.2010	Sabostjan	Vuksani (Rrush)	Mark	Vitore	30.01.1945	Shkodër	M	2 muaj 27 ditë	178,000	0	0	0	0	178,000
67	21733	27.10.2011	Kushtrim	Lame	Gilo	Parfuri	05.06.1944	Ramice, Vlorë	M	7 muaj 13 ditë	460,000	0	74,301	0	0	385,699
68	21735	22.02.2011	Vladimir	Furtuna	Abedin	Merjeme	28.09.1959	Korçë	M	7 muaj 4 ditë	442,000	0	400,000	0	0	42,000
69	21736	07.07.2012	Elsa	Matja	Avdulla	Terezina	30.09.1965	Tiranë	F	3 vjet 17 ditë	2,224,000	0	0	0	0	2,224,000
70	21739	05.04.2013	Fatmir	Arapi	Bayram	Liruze	21.12.1953	Vlorë	M	8 vjet 2 muaj 16 ditë	5,996,000	0	984,001	0	0	5,011,999
71	21742	17.03.2010	Xhelal	Çami (Çami)	Sadik	Mollë	10.02.1955	Tiranë	M	4 vjet 6 muaj 14 ditë	3,320,000	0	545,425	0	0	2,774,575
72	21745	28.06.2014	Vasil	Koça	Stavro	Lena	06.03.1954	Tiranë	M	8 vjet 5 muaj 8 ditë	1,432,000	0	0	0	0	1,432,000
73	21750	27.08.2011	Stefan (Stefo)	Goga	Kristo	Eleferia	01.08.1956	Kakavie, Gjirokastrë	M	3 vjet 10 muaj 29 ditë	2,868,000	0	468,869	0	0	2,399,131
74	21752	02.02.2010	Tahir	Belegu	Ismail	Muhazes	11.06.1959	Tiranë	M	5 vjet 6 muaj 3 ditë	4,028,000	0	1,000,000	0	0	3,028,000
75	21753	18.06.2013	Sabrie	Selimaj	Mustaf	Rushe	24.12.1958	Valbonë, Tropojë	F	1 vit 3 muaj 29 ditë	974,000	159,781	25,000	0	0	789,219
76	21754	17.03.2010	Ardian	Boka	Gjergj	Gjyste	24.09.1969	Lekaj, Shkodër	M	2 vjet 11 ditë	1,482,000	0	240,000	0	0	1,242,000
77	21755	12.04.2012	Paulin	Noshi	Lazër	Angelina	16.12.1959	Shkodër	M	6 muaj 18 ditë	408,000	0	0	0	0	408,000
78	21756	15.05.2013	Albert	Gega	Ndoc	Margjerita	25.05.1964	Lushnje	M	1 vit 7 muaj 10 ditë	1,184,000	0	180,000	0	0	1,004,000
79	21760	10.07.2014	Selman	Bezati	Hekuran	Arta	04.11.1948	Tiranë	M	6 vjet 10 muaj 15 ditë	5,030,000	0	823,555	0	0	4,206,445
80	21761	10.07.2014	Aleks	Bala	Dhimitri	Ollga	16.04.1957	Vlorë	M	2 vjet 2 muaj 7 ditë	1,598,000	0	262,356	0	0	1,335,644
81	21762	24.10.2011	Nikolla (Nikolaos)	Çjarr (Tsiara)	Jorgaq (Georgios)	Ekaterini (Aikaterini)	06.02.1946	Miriqi, Karpenision	M	Dënimi parë: 2 vjet Dënimi dytë: 5 vjet	5,110,000	0	600,329	0	0	4,509,671
82	21763	27.10.2010	Besnik	Erebara	Amedan	Nadire	25.06.1951	Tiranë	M	5 vjet 8 muaj 5 ditë	1,022,000	0	685,465	0	0	336,535
83	21766	03.09.2009	Ibish	Kelmendi	Sadri	Xhevo	03.06.1931	Pejë, Kosovë	M	11 vjet 2 muaj 12 ditë	4,330,000	0	1,200,000	1,256,658	0	1,873,342
84	21767	08.03.2012	Kadri	Llodos	Avdulla	Sheme	20.02.1963	Ninat, Sarandë	M	1 vit 6 muaj 27 ditë	1,156,000	0	0	0	0	1,156,000
85	21768	23.09.2011	Sadri	Kazmaj	Ymer	Hajrije	10.06.1957	Grizhë, Shkodër	M	2 vjet 1 muaj 21 ditë	1,564,000	0	215,000	0	0	1,349,000
86	21769	21.11.2013	Hilmi (Hamdi)	Isufaj	Isuf	Tixhe	15.07.1961	Linaj, Shkodër	M	1 vit 8 muaj 22 ditë	222,000	0	200,000	0	0	22,000
87	21770	30.04.2012	Nadir	Isufi	Mustafa	Hatixhe	22.08.1962	Shkodër	M	1 vit 1 muaj 22 ditë	836,000	0	136,822	0	0	699,178
88	21773	19.08.2009	Pjetrush	Ndoci	Ndue	Katrinë	25.07.1961	Prekal, Shkodër	M	6 vjet 4 muaj 27 ditë	562,000	0	0	0	0	562,000
89	21774	27.10.2010	Bujar	Tafa	Fadil	Emine	06.04.1967	Tiranë	M	3 vjet 3 muaj 8 ditë	1,166,000	0	391,890	0	0	774,110
90	21775	03.03.2017	Ejll	Malaj	Pashko	Dilë	29.09.1955	Ivanaj, Shkodër	M	7 muaj 28 ditë	490,000	0	0	0	0	490,000
91	21777	20.11.2014	Lefter	Roshi	Koçi	Athina	20.11.1956	Vagalat, Sarandë	M	5 vjet 1 muaj 28 ditë	3,472,000	0	619,726	0	0	2,852,274
92	21779	02.02.2015	Zyhdi	Shehu	Hasan	Sadete	20.04.1938	Tiranë	M	13 vjet 4 muaj 6 ditë	1,828,000	200,000	1,403,397	0	0	224,603
93	21781	08.02.2010	Besim	Valteri	Fehmi	Arzije	15.02.1961	Vinjoll, Mat	M	3 vjet 8 muaj 29 ditë	2,744,000	0	450,082	1,232,951	0	1,060,967
94	21783	06.10.2010	Lulash	Thana	Mark	Prenc	30.03.1957	Plan, Shkodër	M	1 vit 7 muaj 5 ditë	1,174,000	0	191,616	0	0	982,384
95	21788	08.03.2017	Hysen	Duda	Medë (Mehmet)	Ismete	25.09.1948	Tiranë	M	2 vjet 11 muaj 26 ditë	1,250,000	0	0	0	0	1,250,000
96	21789	16.03.2017	Yllson	Ylli	Mihal	Safije	22.04.1964	Korçë	M	4 muaj 12 ditë	272,000	0	0	0	13,114	258,886
97	21796	24.10.2011	Andon	Popovski	Cvijetko	Aleksandra	12.02.1956	Vlorë	M	3 vjet 9 muaj 11 ditë	2,582,000	0	0	0	0	2,582,000
98	21797	22.10.2009	Shkelzen	Vellku	Nuredin	Besime	14.10.1969	Bruz Madh, Kukës	M	2 vjet 2 muaj 6 ditë	1,596,000	0	240,000	0	0	1,356,000
99	21798	20.01.2016	Gazmend	Kullau	Faik	Hava	05.08.1971	Kuçovë	M	3 muaj 24 ditë	234,000	0	40,000	0	0	194,000
100	21800	10.11.2016	Rexhep	Demiri	Remzi	Haso	06.05.1949	Sarandë	M	3 vjet 11 muaj 9 ditë	2,250,000	0	472,150	0	0	1,777,850
101	21801	22.11.2016	Qemal	Murati	Hasan	Zyhra	20.09.1944	Derje, Tiranë	M	9 vjet 2 muaj 11 ditë	5,596,000	0	1,054,027	0	0	4,541,973



102	21805	30.07.2010	Gligorag	Vardhami	Jorgo	Arikli	28.02.1948	Tiranë	M	2 vjet 10 muaj 6 ditë	2,092,000	0	335,671	0	0	1,756,329
103	21807	16.01.2017	Mirot	Pllumbaj	Palok	Pashke	06.05.1969	Hot, Shkodër	M	1 vit 7 muaj 5 ditë	1,174,000	0	0	0	0	1,174,000
104	21809	14.07.2009	Gëzim	Sturçe	Kujtim	Nafije	09.06.1953	Shkodër	M	5 muaj 3 ditë	316,000	0	0	0	0	316,000
105	21810	23.12.2011	Piro	Nikolla	Aleks	Vasilqi	21.08.1961	Sarandë	M	4 vjet 4 muaj 16 ditë	3,200,000	0	526,685	0	0	2,673,315
106	21812	05.04.2012	Ramazan	Dervishi	Ismail	Mejte	15.03.1929	Karpen, Durrës	M	11 muaj 26 ditë	734,000	100,000	20,000	0	0	614,000
107	21813	29.06.2010	Ilirjan	Agaraj	Murat	Hënë	02.10.1949	Kropisht, Vlorë	M	11 vjet 1 muaj 4 ditë	8,100,000	0	1,286,891	1,369,982	0	5,443,127
108	21817	21.04.2010	Kajmak	Bojku	Xhavit	Lushe	11.04.1967	Peshkopi, Dibrë	M	3 muaj 28 ditë	242,000	0	0	0	0	242,000
109	21818	16.09.2009	Agron	Seferkolli	Xhemal	Feime	28.02.1960	Arrze, Devoll	M	2 vjet 10 muaj 2 ditë	1,782,000	0	360,000	0	0	1,422,000
110	21820	04.08.2014	Petro	Caci	Thanas	Qerakulla	28.04.1947	Tiranë	M	7 vjet 3 muaj 18 ditë	5,332,000	0	876,164	0	0	4,455,836
111	21823	30.10.2014	Jaho	Cirako (Çiraku)	Qemal	Bule	09.11.1952	Elbasan	M	1 vit 8 muaj 7 ditë	1,240,000	0	0	0	0	1,240,000
112	21824	31.10.2014	Fatmir	Cani	Nezir	Bajame	19.12.1958	Elbasan	M	1 vit 3 muaj 28 ditë	972,000	0	0	0	0	972,000
113	21826	05.01.2012	Bajram	Berisha	Isuf	Prandvera	10.11.1962	Elbasan	M	1 vit 5 muaj 24 ditë	1,024,000	0	150,000	0	0	874,000
114	21828	04.12.2009	Lutfi	Bandula	Abdullah	Qeuthere	10.11.1959	Shkodër	M	4 vjet 2 muaj 18 ditë	3,080,000	0	400,000	0	0	2,680,000
115	21829	15.03.2011	Ilmije	Mici	Ramadan	Shkurte	07.07.1962	Kamëz, Tiranë	F	2 vjet 10 muaj 1 ditë	2,082,000	200,000	300,000	0	0	1,582,000
116	21835	20.01.2011	Bujar	Balliu	Bajram	Mereme	25.07.1961	Tiranë	M	3 vjet 27 ditë	1,164,000	0	368,877	0	0	795,123
117	21836	15.03.2010	Niko	Sholla	Pandi	Marika	04.07.1939	Polene, Korçë	M	6 vjet 8 muaj 28 ditë	4,932,000	100,000	0	0	0	4,832,000
118	21837	01.12.2010	Silvana	Çuni	Hasan	Zade	08.04.1947	Letaj, Kukës	F	6 vjet 2 muaj 4 ditë	4,512,000	200,000	542,027	0	0	3,769,973
119	21846	12.04.2012	Gjergj	Hani	Tomor	Marilda	13.05.1969	Durrës	M	Dënimi parë: 7 muaj 16 ditë Dënimi dytë: 3 vjet 2 muaj 14 ditë	2,808,000	0	300,000	0	0	2,508,000
120	21847	24.11.2009	Bardhul	Haraçi	Muharrem	Fabrice	01.06.1962	Sohodoll, Dibrë	M	3 vjet 10 muaj 7 ditë	2,654,000	0	462,247	0	0	2,191,753
121	21849	24.12.2014	Namik	Ajazi	Begir	Ervehe	14.10.1960	Tiranë	M	3 vjet 10 muaj 27 ditë	2,454,000	0	469,151	0	0	1,984,849
122	21851	24.12.2014	Fatmir	Kurti	Baftiar	Fitnet	08.02.1961	Tiranë	M	2 vjet 4 muaj 21 ditë	1,346,000	0	287,014	0	0	1,058,986
123	21861	08.07.2009	Lefter	Sotiri	Stavro	Ollga	30.01.1950	Tiranë	M	3 vjet 9 muaj	2,748,000	0	2,161,315	0	0	586,685
124	21862	04.07.2012	Jani	Marolli	Petro	Athina	15.06.1964	Dardhë, Librazhd	M	6 muaj 22 ditë	416,000	0	0	0	0	416,000
125	21863	22.09.2015	Përit	Ishmi	Kasem	Mahmudic	28.04.1951	Tiranë	M	2 vjet 7 ditë	1,474,000	0	220,603	0	0	1,253,397
126	21864	12.10.2010	Ndue	Gjeloshaj	Mark	Elena	01.01.1940	Gurëz, Kruië	M	4 vjet 8 muaj 4 ditë	3,424,000	0	561,068	0	0	2,862,932
127	21865	13.02.2013	Skënder	Poka	Kamber	Sibe	28.03.1955	Gjur Reç, Peshkopi	M	2 vjet 8 muaj 4 ditë	860,000	0	321,534	0	0	538,466
128	21869	07.11.2012	Myfit	Velani	Murat	Qeuthere	01.07.1942	Shkodër	M	2 vjet 4 muaj 26 ditë	1,760,000	0	0	0	0	1,760,000
129	21870	26.02.2013	Josif	Shkurti	Trifon	Lefteri	06.07.1964	Durrës	M	1 vit 8 muaj 2 ditë	528,000	0	200,000	0	0	328,000
130	21874	10.08.2009	Jorgji	Mitro	Lilo	Kasjani	29.09.1956	Tiranë	M	7 vjet 2 muaj 30 ditë	3,368,000	0	0	0	0	3,368,000
131	21882	25.04.2017	Kadri	Shemshiri	Hamza	Hamide	20.08.1964	Tiranë	M	3 muaj	112,000	0	0	0	0	112,000
132	21883	26.04.2017	Igli	Shenaj	Ballëm	Liri	01.11.1961	Rreshen	M	3 vjet 10 muaj 17 ditë	2,622,000	0	0	0	0	2,622,000
133	21884	11.05.2017	Dhimiter	Berberi	Kostandin	Refiko	21.08.1948	Nartë, Vlorë	M	1 vit 10 muaj 18 ditë	1,386,000	0	0	0	0	1,386,000
134	21885	11.05.2017	Zeqo (Zeqir)	Braho	Medi	Lefiko	27.11.1959	Tiranë	M	2 muaj 24 ditë	172,000	0	0	0	0	172,000
135	21886	11.05.2017	Artan	Millaj	Mark	Mrikë	19.06.1969	Stajkë, Shkodër	M	4 muaj 29 ditë	306,000	0	0	0	0	306,000
136	21887	23.05.2017	Tonin	Ndoci	Ded	Angelina	07.02.1939	Tiranë	M	1 vit 3 muaj 7 ditë	930,000	100,000	52,219	0	0	777,781
137	21888	27.05.2017	Safer	Ymeri	Emin	Bajame	02.09.1957	Korçë	M	2 muaj 25 ditë	174,000	0	18,411	0	0	155,589
138	21889	27.05.2017	Muharem	Shehu	Myslim	Menduhije	27.11.1958	Korçë	M	2 muaj 25 ditë	174,000	0	0	1,740,490	0	0
139	21890	17.07.2009	Vladimir	Shehu	Muharem	Ismete	20.12.1948	Sulmi, Tiranë	M	Dënimi parë: 1 vit Dënimi dytë: 10 vjet 15 ditë	8,060,000	0	1,205,589	0	0	6,854,411
140	21891	21.06.2017	Flobenc	Hasa	Astrit	Hatixhe	02.07.1967	Elbasan	M	2 vjet 6 muaj 19 ditë	1,794,000	0	0	0	0	1,794,000
141	21897	22.11.2017	Mirash	Toma	Gjok	Mare	17.10.1947	Velipojë, Shkodër	M	2 vjet 16 ditë	1,492,000	0	0	0	0	1,492,000
142	21900	20.12.2017	Edmond	Hoxha	Fuat	Nadire	28.12.1950	Durrës	M	5 vjet 6 muaj 11 ditë	2,358,000	0	600,000	0	0	1,758,000
																263,686,873

**VENDIM****Nr. 7, datë 11.5.2018**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I,
PËR VITIN 2018, GRANTET “ARSIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2018, për grantet “Arsimi”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2018, nga programet buxhetore “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, “Arsimi i lartë” dhe programi për sportin, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas tabelave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të tretë, të vitit 2018. Për fondet e projekteve të

paprokuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të kryejë monitorimin e ecurisë së projekteve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe, periodikisht, Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI**Senida Mesi**

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullave “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik në Lahë e poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 236 prot., datë 7.3.2018, shoqëria “Malësia Solar 1” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.

- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”,

“e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (germa “a”, “c”, “d”), 4.4.4 4.4.5 është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit); pa plotësuar.

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2500 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 62, datë 26.3.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 2” SHPK PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK NË LAHË E POSHTME, SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullave “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 1047/1 prot., datë 6.3.2018, shoqëria “Malësia Solar 2” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.

- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”,

“e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (germat “a”, “c”, “d”), 4.4.4 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit); pa plotësuar

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton rregullorja “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 2” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2500 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 63, datë 26.3.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 3” SHPK PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK NË LAHË E POSHTME, SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të rregullave “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 3” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 1048/1 prot., datë 6.3.2018, shoqëria “Malësia Solar 3” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga impiante fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër.

- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 3” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”,

“e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (germat “a”, “c”, “d”), 4.4.4, 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit); pa plotësuar.

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 3” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, në Lahë e Poshtme, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me fuqi të instaluar 2500 KW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 64, datë 26.3.2018**

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “RTS” SHPK PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA BURIMI GJENERUES I
ENERGJISË FOTOVOLTAIKE,
ZONA TREN–BILISHT, KORÇË**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “RTS” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimi gjenerues i energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë,

konstatoi se:

- Shoqëria “RTS” sh.p.k., me shkresën nr. 12/7 prot., datë 16.10.2017, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimi gjenerues i energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 204, datë 18.12.2017, është shprehur për fillimin e procedurës, për licencimin e shoqërisë “RTS” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga burimi gjenerues i energjisë fotovoltaike, zona Tren - Bilisht, Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të aplikimit të përcjellë nga shoqëria “RTS” sh.p.k., rezulton si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim); plotësuar;
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit); plotësuar;
- germa “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar;

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “a”/”b” (akti i themelimit/statuti), plotësuar;
- germa “c” (vërtetimi i rregjistrimit nga QKB-ja), plotësuar;
- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar;
- germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë), plotësuar;
- germa “f” marrëveshja ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. Subjekti ka paraqitur autorizim paraprak me nr. 5365/6, datë 8.9.2017 dhe autorizimin përfundimtar nga MIE-ja, me nr. 70/2 prot., datë 10.11.2017. Në bazë të pikës 2 të nenit 49, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 22, germa “f”, të VKM-së nr. 822, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt konçensionit”, theksohet: detyrimi që ndërmjet aplikuesit dhe ministrisë të nënshkruhet një kontratë, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve mbi realizimin e këtij projekti dhe penalitetet, në rast mosrealizimi apo transferimi të miratimit, dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e projektit; pa plotësuar;
- germa “g” dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerjeje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premium shitblerjeje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar). Bashkia Devoll konform ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me shkresën nr. 549/1 prot., datë 14.5.2017 drejtuar administratorit të shoqërisë “RTS” sh.p.k. konfirmon bashkëpunimin e saj duke i vënë në dispozicion të ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë, parcelat me nr. 353 dhe nr. 364 të ndodhura në zonën kadastrale nr. 3637, të shoqëruara me hartat përkatëse. (planvendosje) të ndodhura në fshatin Tren, Njësia Administrative Qendër Bilisht. Nëse ky projekt arrin që të marrë nga MIE-ja autorizimin për ndërtimin e këtij impianti, institucioni i Bashkisë Devoll siguron se konform ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen



vendore” se do t’i ofrojë kontratën e shitjes ose qirasë së tokës e cila është pronë e bashkisë Devoll. Edhe mbas plotësimit të marrëveshjes subjekti nuk ka depozituar në ERE kontratën përfundimtare; pa plotësuar.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave): subjekti është themeluar me datë 5.6.2017 dhe nuk ka ushtruar aktivitet financiar më parë.

- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit): subjekti është themeluar me datë 5.6.2017 dhe nuk ka ushtruar aktivitet financiar më parë.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Subjekti ka depozituar një kontratë bashkëpunimi me shoqërinë “Doko” sh.p.k., me nr. 5795 rep. dhe nr. 2195 kol. datë 26.7.2017, ndër të tjera në objekt të kontratës theksohet se: shoqëria “Doko” sh.p.k. do të ofrojë dhe do të vërë në dispozicion për shoqërinë RTS sh.p.k., kapacitetet e saj teknologjike, teknike dhe njerëzore dhe do të bashkëpunojë për të realizuar të gjitha punimet për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë, me fuqi të instaluar 2mw. Pas marrjes të autorizimit përfundimtar nga MIE-ja, ndërmjet palëve do të nënshkruhet një kontratë e veçantë, për realizimin e të gjitha punimeve për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë.

- edhe mbas plotësimit të marrëveshjes subjekti nuk ka depozituar në ERE kontratën përfundimtare, pa plotësuar.

- germa “d” vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s; subjekti ka paguar vetëm 30 000 lekë, për 1.MW. Në bazë të aneksit “A” rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”; subjekti duhet të xhirojë për llogari të ERE-s edhe 30.000 lekë (2 mw x 30.000 lekë/mw = 60.000 lekë); pa plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për centralet solare:

- neni 9, pika 4.4.1 të dhënat teknike për centralet solare, plotësuar;

- neni 9, pika 4.4.2, të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin; plotësuar;

- neni 9, pika 4.3, dokumentacioni teknik dhe grafik; plotësuar;

- neni 9, pika 4.4.4, dokumentacioni tekniko-ekonomik, plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.4.5, leje nga institucione të tjera; plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, duke qenë se kërkesa e paraqitur nga “RTS” sh.p.k., nuk plotëson kushtet e një aplikimi, në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “RTS” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimi gjenerues i energjisë fotovoltaike, zona Tren–Bilisht, Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 65, datë 26.3.2018

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Në mbështetje të neneve 16 dhe 46, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 20 dhe 41, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial”,



konstatohet se:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën të hartojë rregulloren “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.

- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, duke dhënë orientim të përgjithshëm në lidhje me llojin e informacionit tregtar që mund të cilësohet konfidencial, si dhe për rrethanat apo llojin e informacionit që për shkak të parashikimeve të ligjit nuk është konfidencial, por vjen si një detyrim për zbatim të ligjit apo autoritetit të ERE-s për ushtrimin e funksioneve të saj.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 10.1.2018, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.

- ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit me nr. 55/1 prot., datë 17.1.2018, për fillimin e procedurës për miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial” me qëllim marrjen e opinionit të palëve të interesuara.

- Me shkresën nr. 85 prot., datë 22.1.2018, ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës dhe shoqata AAES.

- Në datën 12.2.2018 me korrespondencë elektronike zyrtare i është kërkuar opinion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi të jetë shprehur vetëm Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 50/1 prot., datë 29.1.2018, duke vlerësuar se kjo rregullore nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

KREUI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në përputhje me parashikimin e neneve 16 dhe 46, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; dhe neneve 20 dhe 41, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”. ERE miraton rregullat e praktikës dhe të procedurës, që rregullojnë procedimet e saj për veprimtaritë në sektorin e gazit natyror, përfshirë trajtimin e informacionit konfidencial.

Neni 2 Objekti

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat organizative dhe teknike për mbrojtjen, ruajtjen, sigurinë dhe administrimin dhe asgjësimin e informacionit konfidencial.

2. Kjo rregullore përshkruan konceptin dhe llojet e konfidencialitetit, si dhe masat dhe procedurat për identifikimin, përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial të disponuar nga ERE.

3. Masat e mbrojtjes dhe procedurat për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, të cilat përcaktohen nga kjo rregullore janë të detyrueshme për këdo që përdor informacionin apo dokumente të klasifikuara konfidenciale.

Neni 3 Termet e përdorur

Termet e përdorur në këto rregulla do të kenë të njëjtin kuptim si ata të referuar në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ligjin



nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ligji nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

Neni 4

Llojet e informacionit konfidencial

1. Informacioni konfidencial konsiderohet si më poshtë:

a) informacioni që është identifikuar si konfidencial nga ana e ERE-s, nga personat juridikë dhe fizikë gjatë procedurave nën autoritetin e ERE-s, të pranuar si të tillë nga ERE;

b) informacionet që përcaktohen me ligj ose rregullore të tjera si konfidenciale;

c) informacioni që është klasifikuar si konfidencial me një dokument ligjor ndërkombëtar;

d) informacioni që, sipas natyrës së vet, nuk e ka karakterin e konfidencialitetit, por duke u lidhur me informacione të tjera, informacioni është i tillë që duhet të mbrohet;

e) informacioni që është klasifikuar konfidencial nga një institucion tjetër publik, administrativ apo gjyqësor.

KREU II

MASAT DHE PROCEDURAT PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Neni 5

Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

1. Të gjitha dokumentet konfidenciale dhe informatat e shtypura në letër ose në formë elektronike, të regjistruara, vendosen në një zarf të mbyllur, të shënuar me një shenjë “KONFIDENCIALE” në një vend të dukshëm, duke u regjistruar në një libër të veçantë.

2. Ato arkivohen në mënyrë të veçantë dhe do të ruhen në dollapë të mbyllur në ambientet e ERE-s me akses të kufizuar.

3. Dokumentet dhe informacionet e deklaruar nga ERE si sekret zyrtar, përveç një shënimi “KONFIDENCIALE” gjithashtu përmbajnë shenjë “SEKRET ZYRTAR”.

4. Informacioni dhe dokumenti, konfidencialiteti i të cilit është përcaktuar nga personi i autorizuar i një autoriteti tjetër, ose institucioni, përpunohet dhe përdoret pa ndryshuar llojin,

shkallën dhe kohëzgjatjen e konfidencialitetit.

5. Dokumentet që i bashkëlidhen informacionit konfidencial janë gjithashtu konfidenciale kur kjo është përcaktuar në kërkesën e subjektit.

6. Dokumentet elektronike që përmbajnë të dhëna konfidenciale informacioni dhe bazat e të dhënave elektronike duhet të sigurohen me fjalëkalimin e duhur nga qasje të paautorizuara.

7. Identifikimi i dokumenteve dhe informacionit konfidencial të ERE-s, bëhet me vendim të veçantë të Bordit të ERE-s.

Neni 6

Trajtimi i informacionit konfidencial

1. ERE merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin që përmban informacionin konfidencial nga shkatërime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. ERE nuk mund të lejojë inspektimin ose përdorimin e tyre nga persona të tjerë dhe as të bëjë deklarata në lidhje me këto dokumente dhe informacione pa autorizimin e titullarit të institucionit.

3. Staf i ERE-s që punon në konceptimin, krijimin, shtypjen dhe kopjimin e dokumenteve dhe informacionit konfidencial, duhet të sigurojë këto dokumente përfshirë mbrojtjen e dokumentit dhe materialeve të tjera në kompjuterin e punës, dhe do të marrë masa që të mos cenojnë sigurinë e përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe informacioneve. Kopjimi i dokumenteve konfidenciale dhe informacionit mund të bëhet vetëm pas miratimit paraprak me shkrim të titullarit të institucionit ku secila kopje, transkript dhe të tjetra shënohet me numrin përkatës të serisë nga punonjësi i arkivit.

4. ERE merr masa të veçanta sigurie:

a) Përcakton funksionet ndërmjet strukturave organizative për përdorimin e të dhënave;

b) Përdorimi i të dhënave bëhet me urdher të strukturave organizative ose të personave të autorizuar;

c) Udhëzon nëpunësit, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave,



përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

d) Ndalon hyrjen e personave të paaautorizuar në mjediset e kontrolluesit ose përpunuesit të të dhënave;

e) Aksesit në të dhënat dhe programet, bëhet vetëm nga personat e autorizuar, ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paaautorizuar;

f) Vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm nga personi i autorizuar dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së paaautorizuar në punë;

g) Specialist i IT-së, të institucionit, regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet, përditësimet etj.

h) Sa herë që punonjësit e ERE-s largohen nga vendi i tyre i punës, ata duhet të mbyllin kompjuterët e tyre, dollapët, kasafortat dhe zyrën, në të cilat kanë ruajtur informacionin konfidencial;

i) Nuk duhet të largohen nga mjediset e punës kur ka të dhëna të mbrojtura në tavolinë, dhe ndodhet në prani të personave të cilët nuk janë të punësuar në ERE;

j) Nuk nxjerrin jashtë zyrës, në asnjë rast, kompjuterë, laptopë, fleshë apo pajisje të tjera që përmbajnë informacion konfidencial dhe nuk duhet t'i lënë ato në vende të pasigurta, pa u siguruar për fshirjen apo shkatërrimin e të dhënave;

k) Të dhënat mbrohen duke verifikuar identitetin e përdoruesit dhe duke i lejuar akses vetëm individëve të autorizuar;

l) Kryejnë vazhdimisht procedurën e hyrjes dhe daljes duke përdorur fjalëkalime personale;

m) Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit.

Neni 7

Shënimet në dokumentin konfidencial

1. Regjistrimi i dokumenteve konfidenciale në librin e protokollit të ERE-s do të kryhet në mënyrën e përcaktuar në legjislacionin për veprimtarinë arkivore në Shqipëri.

2. Në çdo rast lëvizja, njohja, komunikimi, dorëzimi dhe veprime të tjera për dokumentin konfidencial, duhet të mbahen shënime nga punonjësi i arkivit, shënime të cilat përfshijnë: emrin dhe funksionin e personit ose emrin e organeve/strukturave të cilave u komunikohen ose

jepen informatat dhe dokumentet konfidenciale, cilat janë informacioni dhe dokumentet e komunikuar, kur dhe për çfarë qëllimi janë komunikuar, si dhe informacione të tjera të nevojshme.

Neni 8

Asgjësimi i dokumenteve konfidenciale

1. Asgjësimi i dokumenteve konfidenciale bëhet nga një komision, në një mënyrë që të garantojë se informacioni konfidencial nuk do të zbulohet dhe në çdo rast mbahet procesverbal asgjësimi.

2. Kryetari përcakton komisionin dhe mënyrën e asgjësimit të dokumentacionit konfidencial.

3. Komisioni prej 3 vetash do të ketë në përbërjen e tij:

a) një punonjës të protokoll-arkivit;

b) një përfaqësues të Drejtorisë Juridike;

c) një përfaqësues të strukturës organike të institucionit, i cili ka pasur apo duhet të ketë akses në materialin konfidencial.

Neni 9

Aksesit i paaautorizuar në informacionin konfidencial

1. Në rast të zbulimit ose zhdukjes së materialeve që përmbajnë informacion konfidencial, personi i cili ka mësuar për këtë, është i detyruar që pa vonesë ta informojë personin përgjegjës në ERE, ose/dhe kryetarin e ERE-s, i cili do të marrë masat e nevojshme për të eliminuar pasojat e pafavorshme dhe për të përcaktuar rrethanat të cilat kanë ndikuar në zbulimin ose zhdukjen e dokumenteve dhe informacionit konfidencial.

2. Të dhënat për dokumentet e zbuluara ose mungesën e tyre dhe informacionin me karakter konfidencial regjistrohen në një procesverbal.

Neni 10

Sigurimi i informacionit konfidencial

Informacioni konfidencial ruhet nga anëtarët e komisionit, i gjithë stafi i ERE-s, si dhe nga të gjithë personat e tjerë të cilët janë të angazhuar për nevojat e ERE-s në punë.

Neni 11

Detyrime të tjera

1. Për dokumentet dhe informacionet që përcaktohen me këtë rregullore si sekret zyrtar, do



të informohen nga ERE palët që shprehin interes për dokumentin e klasifikuar sekret zyrtar.

2. Çdo punonjësi i ERE-s që vihet në dijeni të një informacioni konfidencial dhe njihet me dokumentet e klasifikuara konfidencial, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e përmbajtjes së tyre dhe mban përgjegjësi, për çdo rast të nxjerrjes së sekretit ose publikimit të tyre.

Neni 12

Njoftimi i informacionit konfidencial

Kur informacioni konfidencial është i nevojshëm për kryerjen e detyrave të saj, ERE do të përjashtojë publikun gjatë çdo debati në të cilin publikohen apo diskutohet mbi të dhëna konfidenciale.

Neni 13

Shkelja e detyrës për mbajtjen e informacionit konfidencial

1. Si shkelje e detyrimit të mbajtjes së informacionit konfidencial, do të konsiderohet:

a) Çdo trajtim i informacionit dhe dokumentacionit konfidencial në kundërshtim me këtë rregullore;

b) Komunikimit të paautorizuar, dorëzimit ose tjetërsimit i dokumentacionit konfidencial;

c) Marrjen e informacionit konfidencial për qëllimin e dorëzimit të një personi të paautorizuar.

2. Shkelja e detyrimit e përmendur në pikën 1, germet “a”, “b”, “c” të këtij neni përbën një shkelje serioze të punës sipas përcaktimeve që janë sanksionuar në përputhje me rregullat e ERE-s.

Neni 14

Përjashtim

1. Nuk konsiderohet si shkelje e konfidencialitetit të informacionit nëse ky informacion i është dhënë apo është komunikuar me personat fizikë ose juridikë të cilëve duhet t'u jepet ky informacion në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të tjera në fuqi ose në bazë të autoritetit që rrjedh prej detyrave funksionale të atyre personave ose institucioneve që përfaqësojnë.

2. Nuk konsiderohet si shkelje e informacionit konfidencial, komunikimi për qëllime të një procedure hetimore të një vepër penale, kundërvajtje etj.

Neni 15

Përgjegjësia për shkeljen e rregullit për trajtimin e informacionit konfidencial

1. Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, punonjësi i ERE-s do të mbajë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëse ka ndodhur komunikimi i paautorizuar i të dhënave, nga punonjësi përgjegjës, inicohet një hetim administrativ me qëllim marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës.

Neni 16

Zbatimi

Me dispozitat e kësaj rregulloreje, i gjithë stafi i ERE-s do të informohet drejtpërsëdrejti nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Neni 17

Kontrolli

Mbikëqyrja e zbatimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, në kuptim të kësaj rregulloreje, kryhet me një vendim të veçantë të ERE-s, si pjesë e kontrollit të brendshëm.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

1. Kjo rregullore u miratua nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë me vendimin nr. 65, datë 26.3.2018.

2. Kjo rregullore është objekt rishikimi nga ERE në përputhje me “Rregulloren e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

3. Kjo rregullore hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 66, datë 26.3.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJT JANAR DHE SHKURT 2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, nenit 15 të



rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar dhe shkurt 2018,”

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 875/2 prot., datë 20.2.2018 (protokolluar në ERE, me nr. 72/2, datë 22.2.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar dhe shkurt 2018.

- OSHEE sh.a. e ka paraqitur këtë aplikim/informacion mbi llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në 35 kV, të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar dhe shkurt 2018, në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”.

- Në mbështetje të nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit bazohet në formulën e mëposhtme:

$$\text{ÇFMFt} = \text{KDFPt} + \text{CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

ose:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + 10\% \text{ CBEt} + \text{TRrTSHt}$$

- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. në këtë aplikim u krahasuan me raportimet periodike të OSHEE sh.a., mbi blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajt respektivë, të dërguara në ERE.

- Sa më sipër, në zbatim të pikës 2, të nenit 7 të metodologjisë përkatëse, çmimi maksimal i blerjes së energjisë në treg të parregulluar për muajt janar 2018 rezulton 64.00 euro/MWh dhe për muajt shkurt 2018 rezulton 44.97 euro/ MWh.

- Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në ditën kur është mbyllur procedura e blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar për sistemin e shpërndarjes për muajt janar 2018 rezulton 132.88 lekë/euro dhe për muajt shkurt 2018 rezulton 133.48 lekë/ euro.

- ERE, në datën 2.3.2018, organizoi një seancë dëgjimore, me shoqërinë OSHEE sh.a. në lidhje me përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ku u kërkuar informacion në lidhje me kostot e furnizimit të energjisë elektrike nga ky furnizues, si dhe u la detyrë që OSHEE sh.a. të kryejë një analizë specifike mbi kostot e FMF-së të cilën në periudhën në vazhdim duhet ta paraqesë pranë ERE-s. Në vijim të sa më sipër ERE mundet të kryejë llogaritjet e saj për të përcaktuar nëse marzhi i furnizimit prej 10% i kostos së blerjes së energjisë elektrike, përcaktuar në metodologjinë përkatëse, i mbulon apo jo kostot e furnizimit.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 4396 prot., datë 8.3.2018, paraqiti në ERE informacion mbi kostot e furnizimit të shkaktuara gjatë muajve janar dhe shkurt 2018, të cilat mesatarisht arrijnë në 10% të kostos së blerjes së energjisë. Sipas OSHEE sh.a. norma mesatare prej 10% është brenda përcaktimeve të vendosura dhe në pikën 4, të nenit 6 të metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Kostot e furnizimit me energji elektrike janë llogaritur duke u bazuar në nenet 6 dhe 7 të metodologjisë në fuqi dhe rezultojnë 0.85 lek/kWh për muajt janar 2018 dhe 0.60 lek/kWh për muajt shkurt 2018.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 210, datë 28.12.2017 “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018” është 0.75 lekë/ kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 211, datë 28.12.2017 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” është 1.5 lekë/kWh.

- OSHEE, me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhën janar dhe shkurt 2018, nuk ka mundur të dokumentojë koston e disbalancave për njësi të



energjisë së furnizuar në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për muajt janar–shkurt 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 11.6 (njëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekë/kWh për muajt janar 2018 dhe 9.5 (nëntë pikë pesë) lekë/kWh për muajt shkurt 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 67, datë 26.3.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 84, pikës 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt mars 2018,”

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 3818 prot., datë 1.3.2018 (protokolluar në ERE me nr. 171/4 prot., datë 5.3.2018), ka përcjellë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë

elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajt mars 2018.

- Nga analiza që iu bë aplikimit të OSHEE sh.a. mbi përcaktimin e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, rezulton se sipas llogaritjeve të OSHEE sh.a., çmimi për muajt mars 2018 është 7.74 lekë/kWh.

- OSHEE, me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhën janar dhe shkurt 2018, nuk ka mundur të paraqesë informacion mbi koston e disbalancave për njësi të energjisë së furnizuar në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit edhe për muajt mars 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.5 lekë/kWh për muajt mars 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 68, datë 26.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT “PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE”

Në mbështetje të neneve 16, 65 dhe 97, pikës 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi



relacionin e drejtorive teknike në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e një ndryshimi të propozuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. në “Rregulloren e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, të ndryshuar me vendimet nr. 61, datë 7.7.2014, dhe nr. 76 datë 26.5.2017,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve, e cila miratohet nga ERE në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- ERE, me vendimin me nr. 140, datë 22.11.2013, ka miratuar “Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

- ERE, me vendimin me nr. 61, datë 7.7.2014, ka miratuar disa ndryshime dhe shtesa në “Rregulloren e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”.

- ERE, me vendimin me nr. 76, datë 26.5.2017, ka vendosur miratimin e ndryshimeve në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 7.7.2014 mbi rregullat “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

- Kjo rregullore zbatohet vetëm për kufirin e interkonjeksionit Shqipëri–Kosovë, duke qenë se në Kosovë akoma nuk mund të aplikohen “Rregullat e harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO)”, ndërkohë që për dy kufijtë e tjerë Shqipëri–Greqi dhe Shqipëri–Mal i Zi, ankandet e kapaciteteve të interkonjeksionit zhvillohen në SEE CAO në zbatim të “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO)”, amenduar së fundmi dhe me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 28.9.2017.

- OST sh.a., me shkresën nr. 1713 prot., datë 28.2.2018, ka dërguar në ERE propozimin për një ndryshim në rregullat “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”, miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013, i ndryshuar.

- Shoqëria OST sh.a. ka kërkuar ndryshimin e përcaktimit se si pjesëmarrës të ankandeve duhet të jenë vetëm subjektet tregtare të regjistruar në

Shqipëri. Sipas OST sh.a. ky përcaktim nuk është në përputhje me kërkesat e tregut, por gjithashtu nuk është konform parimeve, frymës dhe përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 97, pika 6.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e një ndryshimi në rregullat “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”, miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013 dhe ndryshuar me vendimet nr. 61, datë 7.7.2014 dhe nr. 76, datë 26.5.2017 të Bordit të ERE-s, si më poshtë:

- Neni 2, paragrafi 6:

Ishte: “Pjesëmarrës i tregut” - është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik dhe që i është nënshtruar të gjitha procedurave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike. Është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik, dhe që ka nënshkruar me OST-në kontratën për përdorimin e kapacitetit ndërkufitar.

Bëhet: “Pjesëmarrës i tregut” - është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik dhe që i është nënshtruar të gjitha procedurave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike. Është një entitet juridik i regjistruar në Shqipëri, i licencuar nga ERE për kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve në sektorin energjetik, dhe që ka nënshkruar me OST-në kontratën për përdorimin e kapacitetit ndërkufitar, si dhe tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet OST sh.a., MEI-n, shoqatën AAES, shoqatën FIAA, AREA dhe Autoritetin e Konkurrencës për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 69, datë 26.3.2018

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “M.T.C. ENERGY” SHPK
PËR LËNIEN PENG NË FAVOR TË
RAIFFEISEN BANK SHA TË ASETEVE
TË SAJ, PËR EFEKT TË
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË**

Në mbështetje të neneve 16, 20, pika “a” dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në zbatim të neneve 7, 10, pika 2 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”; miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi refuzimin e kërkesës për lënie peng të aseteve të shoqërisë MTC Energy sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë,

konstatoi se:

- Shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k., me shkresën e datës 22.12.2017, protokolluar në ERE me nr. 817/2 prot., datë 28.12.2017, ka kërkuar miratimin për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që disponon, në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë dhe për garantimin e detyrimeve të kredisë të marrë nga kjo bankë në datën 28.2.2012.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 12, datë 10.1.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për

lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë.

- Mbas vendimmarjes së sipërcituar, me shkresën nr. 18/2, datë 22.1.2018, është njoftuar subjekti “M.T.C. Energy” sh.p.k. lidhur me këtë vendim të Bordit, si dhe me shkresën nr. 18/3 prot., datë 7.2.2018, i është kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës të depozitojë në ERE dokumentin e miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për lënien peng të aseteve në favor të Raiffeisen Bank.

- Shoqëria, me shkresën datë 19.2.2018, (protokolluar me tonën nr. 18/4, datë 22.2.2018), bën me dije se me shkresën e datës 13.2.2018, i është drejtuar MIE me kërkesën për dhënien e miratimit për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Pas përfundimit të afatit të kërkesës për plotësim dokumentacioni sa sipërcituar, ERE ka ripërsëritur kërkesën për plotësim dokumentacioni me shkresën nr. 18/5 prot., datë 2.3.2018.

- Nga ana e subjektit nuk është depozituar dokumentacioni i munguar dhe i kërkuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për miratimin e lënies peng në favor të Raiffeisen Bank sh.a. të aseteve të saj, për efekt të ristrukturimit të kredisë dhe të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 12, datë 10.1.2018, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë, në favor të Raiffeisen Bank sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë së dhënë”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

**VENDIM****Nr. 70, datë 26.3.2018****MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 123,
SERIA PV11K, SHOQËRISË “HEC
DUNICË” SHPK PËR PRODHIMIN TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“TREBINJË”, “POTGOZHAN”,
“KALIVAÇ”, “DUNICË 1”, “DUNICË 2”,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 27,
DATË 10.3.2011**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germat “ç”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; nenit 18, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 5, germat “ç”, “d” dhe “dh” dhe nenit 9 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 18.4.2017; pikës 6.1, germat “d” dhe “dh” të kushteve të “Licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, si dhe nenit 9, pika 9.3 të rregullores “Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi heqjen e licencës nr. 123, seria T11P, shoqërisë “HEC Dunicë”, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Trebinjë”, “Potgozhan”, “Kalivaç”, “Dunicë 1” dhe “Dunicë 2”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011, konstatoi se:

- Shoqëria tregtare “HEC Dunicë” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 8 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.1.2018), për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 9.2.2016, ka filluar procedurën për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike

shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., me nr. 123, seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Trebinjë”, “Potgozhan”, “Kalivaç”, “Dunicë 1” dhe “Dunicë 2”.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE me shkresën nr. 104/3 prot., datë 23.2.2018, ka njoftuar subjektin “HEC Dunicë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimmarrjen e Bordit dhe pas përfundimit të afatit ligjor të pritjes së komenteve nga palët, nuk ka pasur asnjë reagim.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017, drejtuar shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k. dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Bimëve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhjen e kontratës së konçensionit me nr. 2059 rep., dhe nr. 248/1 kol, datë 16.6.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë, Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vortek” sh.p.k. dhe “By Best Duty Free” sh.p.k. dhe autoritetit shtetëror ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

- Subjekti referuar komunikimit në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 prot., datë 14.6.2017, rezulton se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e tregtimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 18.12.2017, ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2017. Bashkëlidhur listës për subjektet e licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, rezulton edhe subjekti “HEC Dunicë” me nr. 38 rendor, dhe për vitin 2017 i përkon pagesa rregullatore, në shumën 40.000 lekë.

- Referuar rrethanave të sipërcituara, subjekti “HEC Dunicë” rezulton në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e realizimit të projektit të miratuar sipas kontratës së koncesionit, duke kërkuar heqjen e licencës dhe e pagesës së rregullimit për vitin 2017, bazuar kjo në pikën 1, germa “ç”, të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 9, pika 9.3 të rregullores “Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar



me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 190, datë 23.11.2017.

Për gjithë sa më sipër, cituar Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën nr. 123, seria PV11K, shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k., për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et "Trebinjë", "Potgozhan", "Kalivaç", "Dunicë 1" dhe "Dunicë 2", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011.

2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k., për heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017, në shumën 40 000 lekë, për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut, të njoftojë shoqërinë "HEC Dunicë" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 71, datë 26.3.2018

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 124, SERIA T11P SHOQËRISË "HEC DUNICË" SHPK PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE", MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 28, DATË 10.3.2011

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa "ç", "d" dhe "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë të elektrike", nenit 18 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 5, germa "ç", "d" dhe "dh", neni 9 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit nr. 54, datë 18.4.2017, pika 5.1, germa "d" dhe "dh"

të kushteve të "Licencës së tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, si dhe nenit 9, pika 9.3, të rregullores "Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit me nr. 190, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k. me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011,

konstatoi se:

- Shoqëria tregtare "HEC Dunicë" sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 8 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.1.2018, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 9.2.2016, ka filluar procedurën për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k., me nr. 123, seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011.

- Në vijim të këtij vendimi, ERE, me shkresën nr. 104/3 prot., datë 23.2.2018, ka njoftuar subjektin "HEC Dunicë" dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimmarrjen e Bordit dhe pas përfundimit të afatit ligjor të pritjes së komenteve nga palët, nuk ka pasur asnjë reagim.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017, drejtuar shoqërisë "HEC Dunicë" sh.p.k. dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Bimëve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhjen e kontratës së konçensionit me nr. 2059 rep., dhe nr. 248/1 kol. datë 16.6.2009 për ndërtimin e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë, Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Vortek" sh.p.k. dhe "By Best Duty Free" sh.p.k. dhe autoritetit shtetëror ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

- Subjekti referuar shkresave të komunikimit në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 prot., datë 14.6.2017, rezulton se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar



aktivitetin e tregtimit dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 18.12.2017, ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2017. Bashkëlidhur listës për subjektet e licencuara në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton edhe subjekti “HEC Dunicë” sh.p.k. me nr. 16 rendor, dhe për vitin 2017 i përkon pagesa rregullatore, në shumën 40 000 lekë.

- Referuar rrethanave të sipërcituara, subjekti “HEC Dunicë” rezulton në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin dhe ka kërkuar heqjen e licencës dhe e pagesës së rregullimit për vitin 2017, bazuar kjo në pikën 1, germa “ç”, të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 9, pika 9.3, të rregullores “Për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 190, datë 23.11.2017.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën nr. 124, seria T11P, shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., për tregtimin të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011.

2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., për heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017, në shumën 40 000 lekë, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë “HEC Dunicë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 72, datë 26.3.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën me nr. 137 prot., datë 31.1.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 7.3.2018 vendosi: “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”.

- Me shkresën nr. 55/10 prot., datë 9.3.2018 është bërë njoftimi në median e shkruar lidhur me fillimin e procedurave për licencim të shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9,



pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 73, datë 26.3.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“HYDRO SETA” SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et “SETA 1+2”,
“SETA 3” DHE “SETA 4”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, me fuqi të instaluar 7454 KW; “Seta 3”, me fuqi të instaluar 2722 KW dhe “Seta 4”, me fuqi të instaluar 4724 KW dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., me shkresën nr. 165 prot., datë 8.2.2018, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 23.2.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2”, “Seta 3” dhe “Seta 4”.

- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim rezulton se, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Seta” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2” me fuqi të instaluar 7454 kw; “Seta 3” me fuqi të instaluar 2722 kw dhe “Seta 4” me fuqi të instaluar 4724 kw dhe me fuqi totale të instaluar 14900 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

**VENDIM****Nr. 74, datë 26.3.2018**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E DISA SHITESAVE DHE
NDRYSHIMEVE TË PROPOZUARA NGA
SHOQËRIA OSHEE SHA NË
“KONTRATËN TIP PËR SHITBLERJE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
OSHEE SHA DHE PRODHUESVE ME
PËRPARËSI TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 101, DATË 23.6.2016 TË
BORDIT TË ERE-s, I NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR. 147, DATË 30.9.2016
TË BORDIT TË ERE-s**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; VKM-ja nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe fuqizimit me energji elektrike”, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “P”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a. në “Kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 ka vendosur për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE), miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 ka vendosur për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE-së dhe PPE-së, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016.

- Në zbatim të parashikimit të “Kontratës noteriale” të nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Prodhuesit me Përparësi të energjisë elektrike, detyrohet që OSHEE sh.a. brenda datës 28 janar 2018 të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me Prodhuesin me Përparësi të energjisë elektrike, Seman Sunpower sh.p.k.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 902 prot., datë 16.1.2018 (protokolluar në ERE në datën 18.1.2018, me nr. 70 prot.) ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë udhëzim dhe orientim lidhje me këtë situatë, si dhe hapat që duhet të ndërmerre shoqëria OSHEE sh.a.

- Në vijim, shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën me nr. 902/1 prot., datë 9.2.2018 (protokolluar në ERE në datën 12.2.2018 me nr. 110/1 prot.), ka përcjellë në ERE, për vlerësim dhe miratim, draftin me ndryshime të “Kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike” të miratuar nga ERE me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 70/1 prot., datë 16.2.2018, i është përgjigjur shoqërisë OSHEE sh.a. duke bërë me dije se, në gjykimin e ERE-s, lidhja e kontratës për blerjen e energjisë mes OSHEE-së dhe shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. është legjitime duke pasur në vëmendje faktin se operimi në treg nga ana e Shoqërisë dhe transaksionet financiare do të kryhen vetëm pas pajisjes së Shoqërisë me licencën përkatëse nga ana e ERE-s. Garancia e origjinës nuk pengon lidhjen e kontratës së sipërcituar pasi sipas parashikimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, neni 16, certifikata e garancisë së origjinës lëshohet pas vënies në punë të impiantit dhe me kërkesën e të interesuarit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a. në “Kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Shtesat dhe ndryshimet që OSHEE sh.a. ka reflektuar në draftkontratë janë si më poshtë:

Në vijim të gjeneraliteteve të palëve nënshkruese është shtuar:

Duke qenë se:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, në nenin 11 /2 përcakton: “Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE”.

- ERE, me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE), miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”, ka miratuar disa ndryshime në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (sot OSHEE sh.a.) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009.

- ERE, me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE-së dhe PPE-së, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016”, ka miratuar disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 23.10.2009.

- ERE, me vendimin nr. 120, datë 27.7.2017 “Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW”, ka përcaktuar çmimin e blerjes së energjisë.

- Shoqëria _____ sh.p.k. dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë nënshkruar një kontratë “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike” me kapacitet prodhues, në Bashkinë “ _____ në datën _____ me nr. rep., dhe nr. kol.

- Në nenin 6 të kontratës “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike me kapacitet prodhues kw, në Bashkinë, Qarku _____” është përcaktuar si detyrim i MIE-t “të garantojë për 15 vjet blerjen e energjisë në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, sipas çmimit të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 27.7.2017, i cili do të jetë i pandryshueshëm për këtë periudhë.

Te përkufizimi “Ligj”: është zëvendësuar ligji i vjetër i burimeve të rinovueshme me atë aktualisht në fuqi nr. 7/2017.

Në nenin 6, “Matja e energjisë elektrike të livruar” është fshirë pika 6.1 me përmbajtje:

Palët në këtë kontratë do të sigurojnë njëra-tjetrën se livrimet dhe pranimi i energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matje në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së Energjisë.

Është hequr gjithashtu pika 6.8 e nenit 6 me përmbajtje si vijon: Në rastet kur përfaqësuesi i Blerësit nuk paraqitet në datën e caktuar, Shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t’i dërgojë Blerësit faturën. Blerësi është



i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm. Dhe në vend të saj është shtuar pika 6.7 (me numërimin e ri pas fshirjes së dy pikave sipërcituar).

Shitësi do të kryejë procesin e faturimit konform rregullave në fuqi dhe do t'i dërgojë Blerësit faturën apo mundësojë atij leximin *on-line* me sisteme të aksesueshme nga të dyja Palët. Blerësi është i detyruar të shlyejë vlerën e faturuar. Çdo paqartësi për saktësinë e faturës nga ana e Blerësit, do të jetë objekt rishikimi dhe rregullimi në muajt e ardhshëm.

Në nenin 7, “Dokumentimi i procesit të livrimit/pranimet dhe matjes”, është përpunuar përmbajtja e pikës 7.1 si vijon:

7.1 Sipas një kërkesë të arsyeshme, Palët:

a) do t'i sigurojnë njëra tjetrës dokumentacionin që disponojnë, i cili evidenton sasitë, livrimet dhe pranimet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet;

b) do të ndajnë midis tyre çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të verifikuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe reale të energjisë elektrike.

Nga përmbajtja e mëparshme e kësaj pike është hequr teksti: “...do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasitë, livrimet dhe pranimet e energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të masës së shkakut të çdo devijimi nga programi”.

Në nenin 11 “Çmimi”, është shtuar pika 4 me përmbajtje: “ERE përcakton dhe miraton me vendim brenda vitit aktual çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës. Nëse çmimi vjetor miratohet më vonë se fillimi i vitit pasardhës, ky çmim do të jetë i zbatueshëm që nga data 1 janar e vitit pasardhës dhe Palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme në faturat përkatëse për sasitë e lëvruara dhe të faturuara para miratimit të çmimit në përputhje me vendimin përkatës të ERE-s.”.

Në nenin 14 “Përfundimi i kontratës”, është shtuar pika 9 me përmbajtje: “Duke pasur parasysh parashikimet e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 nëse kjo kontratë do të ndryshojë apo zgjidhet si rrjedhojë e një akti normativ të ERE-s apo të drejtat dhe detyrimet e saj do të transferohen në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi që

rregullon sektorin e energjisë elektrike dhe burimeve të rinovueshme dhe jo nga vullneti i secilës palë, pala që mund të kërkojë zgjidhjen është e detyruar të njoftojë palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara ndryshimit, transferimit apo përfundimit të kontratës nëse në legjislacionin e ri nuk parashikohet ndryshe. Në një rast të tillë, Palët do të zbatojnë parashikimet e pikës 8 të këtij neni për likuidimin e detyrimeve financiare midis tyre”.

Në nenin 15 “Afati i kontratës” është hequr teksti: “Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare). Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a. do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me “_____ sh.a.” dhe është shtuar si në vijim:

“15.1 Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare).

15.2 Afati i kontratës do të rishikohet në përputhje me ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore.”.

Në nenin 16, “Hyrja në fuqi”, është hequr teksti: “Kjo kontratë dispozitat e së cilës janë miratuar nga ERE hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët.” dhe është riformuluar si në vijim:

“16.1 Kjo kontratë do të fillojë efektet e saj në momentin e përfundimit të veprës dhe certifikimit të saj sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar ndërmjet Shoqërisë “ dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltai “ “ me kapacitet prodhuese --- kw, në Bashkinë, Qarku “si dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe akteve ligjore dhe nënligjore të dala në funksion dhe mbështetje të këtij ligji, si dhe me licencimin e shoqërisë “ nga Enti Rregullator i Energjisë”.

16.2 Kjo kontratë do të miratohet në Entin Rregullator të Energjisë dhe do t'i njoftohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.”

Në nenin 17 “Amendimi” është fshirë teksti: “Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm apo i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë



apo pazbatueshmërinë e kushteve të termave dhe rregullave të parashikuara në pjesën tjetër të kësaj kontrate” dhe është riformuluar neni si më poshtë:

Neni 17

Ndryshimet dhe amendimet

“17.1 Palët pranojnë që ligji nr. 45/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në funksion dhe mbështetje të tyre, të cilave i nënshtrohet kjo Marrëveshje për ndryshimet në vazhdim dhe që këto ndryshime mund që nga ana e tyre të kërkojnë që amendimet të bëhen në këtë Marrëveshje.

17.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.

17.3 Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshje do të konsiderohet si një ndryshim automatikisht në këtë kontratë”.

VENDIM

Nr. 75, datë 26.3.2018

MBI DETYRIMIN E SHOQËRISË OSHEE SHA PËR NËNSHKRIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA DHE PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 101, DATË 23.6.2016 TË BORDIT TË ERE-s, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 147, DATË 30.9.2016 TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara nga shoqëria OSHEE sh.a. në “Kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 ka vendosur për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE), miratuar me vendimin nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016, ka vendosur për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis OSHEE-së dhe PPE-së, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016.

- Në zbatim të parashikimit të “Kontratës noteriale” të nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Prodhuesit me Përparësi të energjisë elektrike, detyrohet që OSHEE sh.a. brenda datës 28 janar 2018 të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me prodhuesin me përparësi të energjisë elektrike, Sema Sunpower.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 902 prot., datë 16.1.2018 (protokolluar në ERE në datën 18.1.2018, me nr. 70 prot.) ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë udhëzim dhe orientim lidhje me këtë situatë, si dhe hapat që duhet të ndërmerret shoqëria OSHEE sh.a.

- ERE në cilësinë e rregullatorit ka detyrimin të garantojë mbarëvajtjen normale të kësaj kontrate midis OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike. Si e tillë për të mos penguar punën e OSHEE-së dhe PPE-ve në zbatimin e kësaj kontrate, lind nevoja e nënshkrimit të saj nga palët sipas afateve të vendosura në kontratën/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shoqëria OSHEE sh.a. të nënshkruajë brenda afateve të vendosura në kontratë/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme, kontratën tip të shitblerjes së energjisë elektrike, të miratuar nga ERE me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë